RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mjedisit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm dhe transpozim i Direktivës së Shpendëve 2009/147/EC e BE-së dhe Direktivës 1999/22/KE "Për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshtet zoologjike"
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	-Direktiva e Shpendëve 2009/147/EC e BE-së -Direktiva 1999/22/KE "Për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshtet zoologjike
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr. 31, datë 20.01.2016 "Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit"
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	12.06.2026 -10.07.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	06/11/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 26.06.2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 -MMj -Nr.8
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Borana Antoni *e-mail*-i: borana.antoni@mjedisi.gov.al numri i telefonit: 0698654333

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
(Maksimumi 2 faqe)

Fauna e egër përbën një komponent të rëndësishëm të biodiversitetit dhe ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekuilibrave ekologjikë, funksionimin e ekosistemeve dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar, ka krijuar bazën kryesore ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, zhvillimet në fushën e mbrojtjes së natyrës, detyrimet që burojnë nga procesi i integrimit evropian dhe nevoja për zbatim më efektiv të dispozitave ekzistuese kanë evidentuar nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të këtij kuadri ligjor.

Projektligji synon forcimin e kuadrit kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër përmes:

- përafrimit më të plotë me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës;
- përmirësimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të faunës së egër;
- forcimit të masave për mbrojtjen e shpendëve të egër dhe habitateve të tyre;
- krijimit të një kuadri më të qartë për shpalljen, administrimin dhe monitorimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA);

- përmirësimit të kuadrit për autorizimin, funksionimin dhe kontrollin e kopshteve zoologjike;
- përmirësimit të menaxhimit dhe kontrollit të llojeve jo-vendase.

Ndërhyrja propozohet të realizohet përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit ekzistues, si alternativa më proporcionale dhe efektive, duke shmangur krijimin e strukturave të reja administrative dhe duke përdorur mekanizmat institucionalë ekzistue.

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim lidhet me mangësitë e kuadrit aktual ligjor dhe institucional për mbrojtjen e faunës së egër, të cilat kufizojnë zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen, monitorimin dhe menaxhimin e faunës së egër, veçanërisht të shpendëve të egër dhe habitateve të tyre, si edhe përmbushjen e plotë të kërkesave që rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Problematikat kryesore të identifikuara janë:

- mungesa e procedurave të plota për krijimin, shpalljen, administrimin dhe monitorimin e Zonave të Veçanta të Mbrojtjes për Shpendët (Special Protection Areas – SPA);
- mungesa e procedurave të qarta për dhënien e përjashtimeve (derogimeve) nga masat e mbrojtjes së shpendëve të egër;
- mungesa e rregullimit të plotë për introduktimin e llojeve jo-vendase dhe menaxhimin e ndikimeve të tyre mbi biodiversitetin;
- mungesa e një kuadri të plotë ligjor për autorizimin, funksionimin, monitorimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike;
- mungesa e mekanizmave dhe instrumenteve të standardizuara për planifikimin, monitorimin, raportimin dhe kontrollin e masave për mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër;
- paqartësitë në ndarjen e roleve dhe përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit.

Si pasojë e këtyre problematikave, kufizohet efektiviteti i mekanizmave për mbrojtjen e faunës së egër, vështirësohet monitorimi dhe raportimi sipas standardeve të Bashkimit Evropian, dobësohet koordinimi ndërinstitucional dhe krijohen vështirësi në zbatimin e njëtrajtshëm të legjislacionit për mbrojtjen e faunës së egër.

Shkaqet kryesore të problemit lidhen me:

- përditësimin e pamjaftueshëm të kuadrit ligjor kombëtar në raport me zhvillimet e acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës;
- fragmentimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së faunës së egër;
- mungesën e një sistemi të standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër;
- paqartësitë në ndarjen e roleve dhe përgjegjësive ndërmjet institucioneve përgjegjëse;
- kapacitetet e kufizuara teknike dhe institucionale për monitorimin, kontrollin dhe inspektimin.

Problemi prek:

- institucionet publike përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, administrimin e zonave të mbrojtura, monitorimin dhe inspektimin, të cilat përballen me vështirësi në koordinim, zbatim dhe raportim;

- subjektet që administrojnë kopshte zoologjike ose ushtrojnë veprimtari të lidhura me faunën e egër, për shkak të mungesës së një kuadri të plotë dhe të harmonizuar rregullator;
- komunitetin shkencor dhe organizatat e shoqërisë civile, për shkak të kufizimeve në aksesin ndaj të dhënave të standardizuara dhe të krahasueshme mbi faunën e egër;
- qytetarët dhe komunitetet lokale, për shkak të ndikimit që këto problematika kanë në ruajtjen e biodiversitetit, funksionimin e ekosistemeve dhe shërbimet e ekosistemit;

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivi i përgjithshëm është që, deri në vitin 2028, kuadri ligjor dhe institucional për mbrojtjen, menaxhimin dhe monitorimin e faunës së egër të jetë funksional, i monitorueshëm dhe i përafruar me detyrimet përkatëse të Bashkimit Evropian.

Kjo politikë synon arritjen e objektivave të mëposhtme SMART në fushën e mbrojtjes së faunës së egër:

1. Harmonizimi i plotë i kuadrit të brendshëm rregullator me Direktivën 2009/147/KE dhe Direktivën 1999/22/KE deri në përfundim të periudhës afatmesme të zbatimit të politikës,brenda vitit;
2. Sigurimi i integrimit dhe operacionalizimit të 100% të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA) në kuadrin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe në instrumentet përkatëse të planifikimit dhe menaxhimit të territorit, brenda vitit 2028;
3. Sigurimi i formalizimit të ndarjes së kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe inspektimin e faunës së egër, brenda vitit 2027.
4. Sigurimi i funksionalizimit të një sistemi të standardizuar kombëtar për monitorimin dhe raportimin e faunës së egër, veçanërisht të shpendëve dhe habitateve të tyre, brenda vitit 2028, duke garantuar mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të standardizuara për 100% të grupeve të specieve dhe habitateve të përcaktuara në legjislacion;
5. Vendosja dhe zbatimi i nje metodologjie te unifikuar kombetare per monitorimin dhe raportimin e faunes se eger, perditesimi te pakten nje here ne vit i bazes kombetare te te dhenave dhe hartimi i te pakten nje raporti kombetar te monitorimit cdo vit, brenda vitit 2028;
6. Sigurimi i zbatimit të standardeve të unifikuara për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e 100% të kopshteve zoologjike, në përputhje me Direktivën 1999/22/KE, brenda vitit 2028.
7. Forcimi i kontrollit mbi introduktimin e llojeve jo-vendase, përmes vendosjes dhe zbatimit të procedurave të standardizuara për vlerësimin dhe miratimin e tyre, brenda vitit 2028, me synim reduktimin e rrezikut për faunën e egër dhe ekosistemet natyrore.

Objektivat e mësipërm synojnë adresimin e drejtpërdrejtë të problematikave të identifikuara në analizën e problemit, përkatësisht mangësive në përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian, mungesës së një sistemi të standardizuar të monitorimit dhe raportimit të faunës së egër, paqartësive në ndarjen e përgjegjësive institucionale, si dhe nevojës për një kuadër më të plotë rregullator për administrimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët, kopshteve zoologjike dhe kontrollin e llojeve jo-vendase. Arritja e këtyre objektivave pritet të përmirësojë efektivitetin e zbatimit të legjislacionit, koordinimin

ndërinstitucional dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Janë shqyrtuar katër opsione kryesore politike për adresimin e problematikave të identifikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e faunës së egër dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni 0 – Mosndërhyrja (Ruajtja e status quo-sw)- Nuk kryhet asnjë ndryshim në legjislacionin ekzistues.

Avantazhe / përfitime

- nuk kërkon burime administrative shtesë;
- nuk krijon nevojë për ndryshime institucionale;
- shmang kostot e implementimit të menjëhershëm.

Disavantazhe / kosto

- ruan fragmentimin e kuadrit ligjor;
- nuk përmirëson sistemin e monitorimit dhe raportimit;
- nuk adreson boshllëqet në transpozimin e Direktivës 2009/147/KE dhe 1999/22/KE;
- rrezikon mos-përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Kapitullit 27;
- nuk përmirëson koordinimin institucional.

Ky opsion nuk adreson problemin dhe nuk është i përshtatshëm.

Opsioni 1 – Kryerja e ndryshimeve dhe shtesave në ligjin ekzistues (opsioni i preferuar)- Ndërhyrje e targetuar në Ligjin nr. 10006/2008 përmes ndryshimeve dhe shtesave për të adresuar boshllëqet ekzistuese dhe për të përmirësuar përafrimin me acquis të BE-së.

Avantazhe / përfitime

- ruan strukturën bazë të kuadrit ekzistues ligjor;
- lejon ndërhyrje të shpejtë dhe të fokusuara;
- përmirëson transpozimin e Direktivave 2009/147/KE dhe 1999/22/KE;
- krijon bazë ligjore për sistem të integruar monitorimi dhe raportimi;
- qartëson përgjegjësitë institucionale;
- përmirëson funksionimin e regjimit për kopshtet zoologjike dhe llojet invazive.

Disavantazhe / kosto

- nuk përbën ristrukturim të plotë të kuadrit ligjor;
- disa dispozita mbeten të varura nga aktet nënligjore;
- kërkon koordinim të shtuar ndërinstitucional gjatë zbatimit;
- nuk eliminon plotësisht kompleksitetin e kuadrit ekzistues.

Ky opsion konsiderohet më i përshtatshmi pasi:

- **siguron balancë midis efektivitetit dhe shpejtësisë së zbatimit;**
- **garanton përmirësim të ndjeshëm të përafrimit me acquis të BE-së;**
- **shmang kostot dhe kompleksitetin e hartimit të një ligji të ri;**
- **lejon përdorimin e strukturave ekzistuese institucionale.**

Opsioni 2 – Hartimi i njw ligji të ri- hartimi i një ligji të ri gjithëpërfshirës për faunën e egër që zëvendëson kuadrin ekzistues.

Avantazhe / përfitime

- ristrukturim i plotë i kuadrit ligjor;
- koherencë më e lartë normative;
- mundësi për kodifikim të plotë të acquis të BE-së;
- eliminim i fragmentimit ekzistues.

Disavantazhe / kosto

- proces i gjatë dhe kompleks legjislativ;
- kërkon kapacitete të larta institucionale dhe teknike;
- rrit rrezikun e vonesave në procesin e përafrimit;
- nuk është i domosdoshëm në fazën aktuale të zhvillimit institucional.

Opsioni 3 – Qasje jo-rregullatore- Adresimi i problematikave përmes instrumenteve jo-ligjore (udhëzime, politika, praktika administrative).

Avantazhe / përfitime

- fleksibilitet i lartë;
- kosto minimale implementimi;
- mundësi zbatimi të shpejtë në nivel administrativ.

Disavantazhe / kosto

- mungesë e detyrueshmërisë ligjore;
- nuk siguron përafrim formal me acquis të BE-së;
- nuk adreson boshllëqet strukturore të ligjit;
- efekt i kufizuar në përmirësimin e sistemit të monitorimit dhe kontrollit.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Vlerësimi i ndikimeve të projektligjit është kryer duke analizuar efektet e pritshme që zbatimi i opsionit të preferuar do të ketë në:

- mjedis dhe faunën e egër;
- ekonomi dhe aktivitetet e lidhura me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;
- buxhetin e shtetit;
- administratën publike;
- biznesin dhe subjektet e prekura;
- shoqërinë dhe komunitetet lokale;
- procesin e integrimit evropian.

Duke qenë se projektligji synon kryesisht përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen, menaxhimin dhe monitorimin e faunës së egër, ndikimet kryesore të pritshme janë afatmesme dhe afatgjata dhe lidhen me përmirësimin e statusit të ruajtjes së faunës së egër dhe habitateve të saj, forcimin e monitorimit dhe raportimit, përmirësimin e koordinimit institucional dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

1. Ndikimi në mjedis dhe faunën e egër

Ky është ndikimi kryesor i ndërhyrjes dhe pritet të jetë pozitiv, veçanërisht në afatmesëm dhe afatgjatë.

Ndikimi pozitiv pritet të realizohet përmes:
a) Përmirësimit të mbrojtjes së llojeve të faunës së egër
Projektligji synon forcimin e masave për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër, veçanërisht të shpendëve të egër, përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të masave të ruajtjes.
Ndikimi i pritshëm është përmirësimi i statusit të ruajtjes së llojeve dhe reduktimi i rrezikut të ndikimeve negative mbi popullatat e faunës së egër.
b) Përmirësimit të mbrojtjes së habitateve
Forcimi i kuadrit për mbrojtjen dhe menaxhimin e habitateve të shpendëve të egër pritet të kontribuojë në ruajtjen e kushteve ekologjike të nevojshme për mbijetesën dhe riprodhimin e llojeve.

c) Forcimit të mbrojtjes dhe menaxhimit të SPA-ve
Integrimi dhe operacionalizimi i Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët pritet të përmirësojë mbrojtjen dhe menaxhimin e habitateve me rëndësi për shpendët e egër dhe të forcojë monitorimin e tyre.
d) Forcimit të kontrollit mbi llojet jo-vendase
Vendosja e procedurave të standardizuara për vlerësimin dhe miratimin e introduktimit të llojeve jo-vendase synon reduktimin e rrezikut që këto lloje mund të paraqesin për speciet vendase dhe ekosistemet natyrore.
e) Përmirësimit të monitorimit dhe raportimit
Funksionalizimi i një sistemi të standardizuar kombëtar për monitorimin dhe raportimin do të përmirësojë disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave për gjendjen e faunës së egër dhe do të mbështesë vendimmarrjen dhe zbatimin e masave të ruajtjes.

2. Ndikimet mbi administratën publike
Ndikimi mbi administratën publike pritet të jetë kryesisht funksional dhe organizativ.
Projektligji synon qartësimin e kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e faunës së egër, si dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional.
Zbatimi i projektligjit nuk parashikon krijimin e institucioneve apo strukturave të reja administrative. Detyrimet e reja pritet të përmbushen nëpërmjet strukturave ekzistuese institucionale dhe burimeve njerëzore, administrative dhe financiare në dispozicion.
Megjithatë, mund të ketë nevojë për përshtatje të procedurave ekzistuese, standardizim të metodologjive, përmirësim të sistemeve të raportimit dhe forcim të kapaciteteve teknike.

3. Ndikimet ekonomike
Ndikimet ekonomike të projektligjit lidhen kryesisht me kostot e zbatimit për institucionet dhe subjektet e prekura, si dhe me përfitimet e pritshme nga përmirësimi i menaxhimit të faunës së egër dhe zonave natyrore.
Për subjektet private, kostot lidhen kryesisht me përshtatjen me kërkesat ligjore dhe administrative. Megjithatë, këto kosto shoqërohen me përfitime të mundshme nga rritja e sigurisë rregullatore dhe krijimi i kushteve më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me turizmin natyror dhe ekoturizmin.
Në afatmesëm dhe afatgjatë, përmirësimi i statusit të ruajtjes së faunës së egër dhe habitateve të saj mund të kontribuojë në rritjen e potencialit ekonomik të zonave me vlera të larta natyrore.

4. Ndikimi mbi buxhetin e shtetit
Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, 'Për mbrojtjen e faunës së egër', i ndryshuar" nuk parashikon krijimin e strukturave të reja

institucionale apo rritje të numrit të punonjësve. Zbatimi i tij synohet të realizohet përmes strukturave dhe kapaciteteve institucionale ekzistuese.
Kostot e identifikuara në analizën ekonomike përfaqësojnë kostot ekonomike të zbatimit të ndërhyrjes së propozuar dhe lidhen kryesisht me monitorimin e faunës së egër, angazhimin e strukturave të pushtetit vendor dhe strukturave përgjegjëse për administrimin e zonave të mbrojtura. Këto kosto nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht nevojë për financim shtesë nga buxheti i shtetit, pasi zbatimi parashikohet të realizohet nëpërmjet strukturave dhe fondeve ekzistuese.
Për Opsionin 1 – ndryshimi i ligjit ekzistues, i cili është edhe opsioni i preferuar, analiza monetare paraqet:

- Vlera aktuale e kostove: 21857 mijë lekë;
- Vlera aktuale e përfitimeve: nuk eshte monetizuar
- Vlera aktuale neto (VAN): 21857 mijë lekë.

Përfitimet e identifikuara lidhen kryesisht me përmirësimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të faunës së egër, forcimin e monitorimit dhe raportimit, përmirësimin e zbatimit të legjislacionit dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian. Përfitimet e tjera afatgjata mjedisore dhe institucionale, për të cilat nuk disponohen të dhëna të mjaftueshme për një vlerësim monetar të besueshëm, janë trajtuar përmes analizës cilësore.

5. Ndikimi mbi biznesin dhe SME-të
Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që mund të preken nga zbatimi i projektligjit përfshijnë kryesisht subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e ekoturizmit, administrimit të kopshteve zoologjike, aktiviteteve rekreative në natyrë dhe veprimtarive të tjera të lidhura me përdorimin e burimeve natyrore.

Projektligji nuk vendos tarifa, taksa apo detyrime të reja financiare të drejtpërdrejta për këto subjekte. Ndikimi ekonomik mbi SME-të vlerësohet si i kufizuar dhe kryesisht indirekt.
Në afatmesëm dhe afatgjatë, përmirësimi i mbrojtjes së faunës së egër, rritja e sigurisë juridike dhe përmirësimi i menaxhimit të zonave natyrore mund të krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike, veçanërisht në turizmin natyror dhe ekoturizmin.
Nuk pritet ndikim negativ i rëndësishëm në konkurrueshmërinë e SME-ve, pasi kërkesat rregullatore zbatohen në mënyrë të njëjtë për subjektet që operojnë në këtë fushë.

6. Ndikimet sociale
Punësimi-Projektligji nuk parashikon krijimin e vendeve të reja të punës në administratën publike, pasi detyrimet e tij do të përmbushen nga strukturat ekzistuese.
Në afatmesëm dhe afatgjatë, përmirësimi i menaxhimit të zonave natyrore dhe zhvillimi i turizmit natyror dhe ekoturizmit mund të krijojnë mundësi të reja punësimi në sektorët e turizmit, shërbimeve dhe aktiviteteve të lidhura me natyrën.

Komunitetet locale- Ndikimi pritet të jetë pozitiv në komunitetet që ndodhen pranë zonave me vlera të larta natyrore, përmes krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike dhe turizmit natyror.

Barazia territorial-Projektligji zbatohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk parashikon trajtim të diferencuar ndërmjet rajoneve. Përmirësimi i menaxhimit dhe mbrojtjes së faunës së egër pritet të sjellë përfitime të shpërndara në mënyrë më të gjerë në territor.

7. Ndikimi në mirëqenie dhe edukimin mjedisor

Përmirësimi i mbrojtjes së faunës së egër dhe habitateve të saj pritet të ketë ndikim pozitiv në cilësinë e mjedisit dhe, në mënyrë indirekte, në mirëqenien e komuniteteve.
Gjithashtu, forcimi i rolit të kopshteve zoologjike si qendra edukimi dhe ndërgjegjësimi pritet të kontribuojë në rritjen e edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e faunës së egër.

8. Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me:

- përmirësimin e statusit të ruajtjes së faunës së egër dhe habitateve;
- forcimin e shërbimeve të ekosistemit;
- rritjen e potencialit për zhvillimin e turizmit natyror dhe ekoturizmit;
- forcimin e kërkimit shkencor dhe përdorimit të të dhënave mjedisore;
- rritjen e ndërgjegjësimit publik për mbrojtjen e natyrës.

Këto përfitime janë kryesisht afatgjata dhe, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të monetizohen plotësisht.

9. Ndikimet pa vlerë monetare

Përveç ndikimeve të monetizuara në analizën kosto–përfitim, projektligji pritet të sjellë përfitime të rëndësishme që nuk mund të shprehen plotësisht në terma monetarë.

Këto përfshijnë forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e faunës së egër, qartësimin e përgjegjësive institucionale, përmirësimin e monitorimit dhe raportimit, përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur si **Opsioni 1 – ndryshimi i ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar**, pasi analiza e vlerësimit të boshllëqeve ligjore ka identifikuar nevojën për ndërhyrje të synuara në kuadrin ekzistues ligjor, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës në lidhje me faunën e egër.

Nga analiza rezulton se ndryshimet e nevojshme nuk e tejkalojnë kufirin strukturor të ligjit ekzistues dhe nuk kërkojnë hartimin e një akti të ri ligjor, por përmirësimin dhe plotësimin e dispozitave ekzistuese. Për këtë arsye, rishikimi i ligjit ekzistues është vlerësuar si opsioni më efikas, më proporcional dhe më i shpejtë për arritjen e objektivave të politikës.

Opsioni i preferuar garanton përmirësimin e koordinimit institucional, ndarjen më të qartë të përgjegjësive, si dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit, duke kontribuar në përmirësimin e statusit të ruajtjes së faunës së egër dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës

Zbatimi i projektligjit nuk parashikon krijimin e institucioneve të reja, rritje të numrit të punonjësve apo detyrime të reja të drejtpërdrejta financiare për buxhetin e shtetit. Zbatimi i

dispozitave të tij do të realizohet nëpërmjet strukturave ekzistuese institucionale dhe burimeve njerëzore, administrative dhe financiare të institucioneve përgjegjëse. Çdo nevojë për përshtatje administrative ose masa zbatuese shtesë do të trajtohet brenda kuadrit të procedurave të planifikimit buxhetor dhe fondeve të miratuara për institucionet përgjegjëse.

Vlerësimet orientuese të paraqitura në analizën kosto–përfitim pasqyrojnë efektet ekonomike të përgjithshme të zbatimit të projektligjit dhe nuk përfaqësojnë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit. Për këtë arsye, ndikimi shtese buxhetor i projektligjit në periudhën trevjeçare vlerësohet si zero.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
2,946	2,712	1,858

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Më datë 12.06.2026 projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar së bashku me relacionin shpjegues janë publikuar për konsultim publik në Regjistrin elektronik të Konsultimit Publik në ëebsite https://ëë.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/991. Projektligji ka qëndruar i publikuar për konsultim publik deri më datë 10.07.2026 dhe gjithsej ka patur 229 shikime. Gjatë periudhës së konsultimit publik nuk u paraqitën komente ose propozime konkrete nga grupet e interesit. Për rrjedhojë, nuk pati ndryshime në përmbajtjen e projektligjit si rezultat i këtij procesi. Megjithatë, procesi i konsultimit kontribuoi në rritjen e transparencës gjatë hartimit të projektligjit dhe në informimin e palëve të interesuara mbi objektivat dhe ndërhyrjet e propozuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi i dispozitave të këtij projektligji do të realizohen në përputhje me përcaktimet e tij dhe do të mbështeten në aktet nënligjore që do të miratohen nga ministri përgjegjës për mjedisin, në zbatim të tij.
Zbatimi i ligjit do të realizohet përmes bashkëpunimit institucional ndërmjet ministrisë përgjegjëse për mjedisin, njësive të vetëqeverisjes vendore, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe strukturave të saj rajonale, si dhe Inspektoratit shtetëror përgjegjës për mjedisin dhe kontrollin në terren. Këto institucione do të jenë përgjegjëse për zbatimin e masave të ruajtjes së shpendëve të egër, administrimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura

për Shpendët, si dhe monitorimin e respektimit të kërkesave ligjore për mbrojtjen e faunës së egër.
Ministria përgjegjëse për mjedisin do të ketë rol koordinues dhe mbikëqyrës në procesin e zbatimit, duke siguruar analizimin e raporteve periodike, përfshirë raportimet që përgatiten në kuadër të detyrimeve ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, si dhe raportet mbi zbatimin e përjashtimeve nga regjimi i mbrojtjes së shpendëve dhe masat për kontrollin e introduktimit të llojeve jo-vendase.
Gjithashtu, ministria do të sigurojë monitorimin e zbatimit të regjimit të autorizimit për kopshtet zoologjike, përfshirë respektimin e standardeve për mirëqenien e kafshëve, sigurinë dhe funksionimin e tyre, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore dhe strukturat e inspektimit.
Të dhënat e mbledhura nga procesi i monitorimit do të përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe masave për mbrojtjen dhe ruajtjen e faunës së egër, si dhe për forcimin e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Monitorimi i zbatimit të ligjit do të bazohet në raportet periodike të institucioneve përgjegjëse, në të dhënat e sistemit kombëtar të monitorimit të faunës së egër dhe në raportimet që përgatiten në kuadër të detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian.
Zbatimi i projektligjit pritet të monitorohet përmes treguesve të tillë si:

- statusi i ruajtjes së llojeve të shpendëve të egër;
- sipërfaqja dhe gjendja e habitateve të mbrojtura;
- numri i monitorimeve dhe inspektimeve të kryera;
- numri i rasteve të shkeljeve të konstatuara;
- numri i raporteve të përgatitura sipas kërkesave të acquis të Bashkimit Evropian;
- numri i vizitorëve në zonat e mbrojtura.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kuadri ligjor kryesor në fushën e mbrojtjes së faunës së egër përbëhet nga ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar.
Ky ligj ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 41/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006/2008", të cilat kanë synuar përmirësimin e disa dispozitave lidhur me forcimin e masave të mbrojtjes së specieve të egra, rritjen e efektivitetit të zbatimit dhe përafrimin e mëtejshëm me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe faunës së egër.

Ndryshimet ligjore janë ndërmarrë kryesisht për të adresuar boshllëqet e evidentuara në zbatim, për të forcuar instrumentet administrative dhe për të përmirësuar koordinimin institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e faunës së egër dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Kuadri rregullator plotësohet nga aktet nënligjore në fuqi, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për mjedisin, të cilat rregullojnë aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit, përfshirë:

- VKM nr. 804, datë 21.11.2007 "Për shpalljen dhe administrimin e zonave të mbrojtura natyrore", i ndryshuar, i cili përcakton procedurat për shpalljen, kategorizimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura;

- VKM nr. 102, datë 04.02.2015 "Për miratimin e listës së specieve të mbrojtura të faunës dhe florës së egër", e cila përcakton regjimin e mbrojtjes së specieve në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- VKM nr. 59, datë 26.01.2011 "Për miratimin e rregullave për administrimin e faunës së egër", që rregullon përdorimin, monitorimin dhe mbrojtjen e llojeve të faunës së egër;
- Udhëzimi për procedurat e inspektimit mjedisor në fushën e mbrojtjes së faunës së egër, që rregullon kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të legjislacionit në terren.

Në vijim të zhvillimit të kuadrit ligjor kombëtar dhe angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, legjislacioni për mbrojtjen e faunës së egër është zhvilluar gradualisht me qëllim forcimin e masave për ruajtjen e biodiversitetit dhe harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë. Në kuadër të procesit të integrimit evropian, kuadri ligjor shqiptar në fushën e mbrojtjes së faunës së egër synon përafrimin me dispozitat kryesore të acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egër" dhe Direktivën 92/43/KEE "Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër". Këto akte përcaktojnë detyrime për ruajtjen e specieve, menaxhimin e zonave me rëndësi ekologjike dhe monitorimin e gjendjes së biodiversitetit.

Shqipëria është gjithashtu palë në disa marrëveshje dhe konventa ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për zhvillimin e kuadrit kombëtar. Ndër këto përfshihen Konventa për Diversitetin Biologjik (CBD), Konventa për Ruajtjen e Jetës së Egër dhe Habitateve Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës), si dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e specieve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.Zbatimi i dispozitave për mbrojtjen e faunës së egër lidhet edhe me kuadrin tjetër rregullator në fushën e mjedisit dhe përdorimit të burimeve natyrore, përfshirë legjislacionin për zonat e mbrojtura, vlerësimin e ndikimit në mjedis, biodiversitetin, pyjet, gjuetinë, peshkimin dhe inspektimin mjedisor. Kjo kërkon koordinim ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për mjedisin, zonat e mbrojtura, kontrollin dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Zbatimi i ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër", i ndryshuar, realizohet nëpërmjet një sistemi të integruar përgjegjësish ndërmjet institucioneve përgjegjëse për hartimin e politikave, menaxhimin e zonave të mbrojtura, monitorimin e biodiversitetit, kontrollin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes së faunës së egër. Ligji përcakton se fauna e egër është pasuri kombëtare dhe mbrojtja, menaxhimi dhe kontrolli i saj realizohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave kombëtare, përcaktimin e drejtimeve strategjike për mbrojtjen e faunës së egër dhe koordinimin e zbatimit të kuadrit ligjor në këtë fushë. Ministria miraton politika, udhëzime dhe akte nënligjore për administrimin dhe ruajtjen e biodiversitetit, si dhe koordinon institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka rol në monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe biodiversitetit, përfshirë mbledhjen dhe administrimin e të dhënave për treguesit mjedisorë. Në fushën e faunës së egër, monitorimi realizohet nëpërmjet programeve të monitorimit të miratuara dhe raportimit të të dhënave mbi gjendjen e specieve dhe habitateve. Ligji parashikon që agjencia përgjegjëse për monitorimin e mjedisit realizon monitorimin periodik të treguesve të veçantë të faunës së egër, sipas kalendarëve dhe metodologjive përkatëse.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe administratat e zonave të mbrojtura kanë përgjegjësi për menaxhimin praktik të territoreve të mbrojtura ku ndodhen

habitate dhe specie të faunës së egër. Funksionet e tyre përfshijnë zbatimin e planeve të menaxhimit, ruajtjen e habitateve, monitorimin e specieve, kontrollin e aktiviteteve në zonat e administruara dhe bashkëpunimin me komunitetet lokale.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi në shqyrtim lidhet me faktin se sistemi aktual për mbrojtjen, menaxhimin dhe monitorimin e faunës së egër nuk siguron një qasje të plotë, të integruar dhe efektive për ruajtjen e llojeve dhe habitateve të tyre. Ky problem shfaqet përmes vështirësive në zbatimin e masave për mbrojtjen e faunës së egër, mungesës së mekanizmave të unifikuar të monitorimit dhe raportimit, si dhe paqartësive në administrimin dhe kontrollin e disa elementeve të rëndësishme të menaxhimit të faunës së egër.

Problematikat kryesore të identifikuara lidhen me:

- **mungesën e një sistemi të plotë dhe të standardizuar për monitorimin, mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër;**

Problematika lidhet me mungesën e një sistemi të unifikuar, të standardizuar dhe funksional për monitorimin, mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër në territorin e Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, të dhënat mbi shpërndarjen, madhësinë dhe tendencat e popullatave të llojeve të faunës, gjendjen e habitateve të tyre, kërcënimet që i prekin, si dhe efektivitetin e masave mbrojtëse, mund të mblidhen nga institucione dhe struktura të ndryshme, por jo gjithmonë në mënyrë të koordinuar, të krahasueshme dhe të përditësuar.

Mungesa e metodologjive të unifikuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe e një mekanizmi të centralizuar për administrimin dhe shkëmbimin e tyre, krijon vështirësi në krijimin e një panorame të plotë dhe të besueshme mbi gjendjen e faunës së egër. Në këto kushte, të dhënat mund të jenë të fragmentuara, të mbledhura në periudha të ndryshme, me metoda të ndryshme ose të kufizuara vetëm në zona dhe lloje të caktuara. Kjo e vështirëson krahasimin e informacionit ndër vite, identifikimin në kohë të rënies së popullatave apo të përkeqësimit të gjendjes së habitateve dhe vlerësimin e tendencave afatgjata.

Mungesa e një sistemi të integruar ndikon gjithashtu në cilësinë e procesit të vendimmarrjes. Institucionet përgjegjëse mund të mos disponojnë informacion të mjaftueshëm, të përditësuar dhe të verifikuar për të përcaktuar prioritetet e ruajtjes, për të hartuar masa të përshtatshme mbrojtëse, për të orientuar burimet financiare dhe njerëzore ose për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra. Për pasojë, ndërhyrjet mund të jenë të pjesshme, të vonuara ose të mos adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë kërcënimet kryesore ndaj llojeve dhe habitateve të tyre.

Problematika shoqërohet edhe me vështirësi në koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mjedisin, zonat e mbrojtura, inspektimin, kërkimin shkencor dhe administrimin e territorit. Mungesa e përcaktimit të qartë të roleve, përgjegjësive, procedurave dhe afateve për raportimin e të dhënave mund të çojë në mbivendosje të veprimtarive, mungesë të informacionit për disa lloje ose zona dhe përdorim joefektiv të burimeve në dispozicion.

Një tjetër pasojë lidhet me kufizimin e mundësisë për të vlerësuar në mënyrë objektive gjendjen e ruajtjes së llojeve të faunës së egër dhe për të matur rezultatet e politikave dhe masave të mbrojtjes. Pa tregues të unifikuar dhe të dhëna të krahasueshme, është e vështirë të përcaktohet nëse masat e ndërmarra kanë sjellë përmirësim të gjendjes së llojeve dhe habitateve, nëse kërkohen ndërhyrje shtesë ose nëse masat ekzistuese duhet të rishikohen.
Për rrjedhojë, mungesa e një sistemi të plotë dhe të standardizuar të monitorimit dhe raportimit mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen efektive të faunës së egër, në identifikimin e hershëm të rreziqeve dhe kërcënimeve, në planifikimin e masave të ruajtjes dhe në përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit.

- **mangësitë në rregullimin e procedurave për krijimin, shpalljen dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA);**

Problematika lidhet me mungesën e një kuadri të plotë dhe të detajuar ligjor për përcaktimin e procedurave, kritereve dhe përgjegjësive institucionale që lidhen me identifikimin, shpalljen, menaxhimin dhe monitorimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (Special Protection Areas – SPA) në territorin e Republikës së Shqipërisë. Aktualisht, kuadri ekzistues ligjor për mbrojtjen e natyrës dhe zonave të mbrojtura nuk parashikon në mënyrë të plotë të gjitha elementet procedurale dhe teknike të nevojshme për funksionimin efektiv të një sistemi të harmonizuar për krijimin dhe administrimin e këtyre zonave, në përputhje me kërkesat e Direktivës së Shpendëve 2009/147/KE.
Mungesa e procedurave të qarta për identifikimin dhe propozimin e zonave me rëndësi të veçantë për ruajtjen e shpendëve krijon vështirësi në sigurimin e një procesi të unifikuar dhe të bazuar në kritere shkencore. Përcaktimi i zonave të tilla kërkon përdorimin e të dhënave të besueshme mbi praninë, shpërndarjen, madhësinë e popullatave dhe tendencat e llojeve të shpendëve, si dhe vlerësimin e rëndësisë ekologjike të habitateve përkatëse. Në mungesë të një procedure të standardizuar, ekziston rreziku që procesi i identifikimit dhe shpalljes së zonave të mos jetë i plotë, transparent dhe i krahasueshëm me standardet e kërkuara në nivel evropian.
Gjithashtu, mungesa e një përcaktimi të qartë të rolit dhe përgjegjësive të institucioneve të përfshira në procesin e krijimit dhe menaxhimit të SPA-ve mund të ndikojë në koordinimin ndërinstitucional dhe në zbatimin efektiv të masave të ruajtjes. Administrimi i këtyre zonave kërkon bashkëpunim ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, administrimin e zonave të mbrojtura, monitorimin e biodiversitetit dhe kontrollin e aktiviteteve njerëzore që mund të ndikojnë në gjendjen e ruajtjes së llojeve dhe habitateve.
Një problem tjetër lidhet me mungesën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet shpalljes së një SPA-je dhe përcaktimit të objektivave konkrete të ruajtjes, masave të menaxhimit dhe mekanizmave të monitorimit. Pa përcaktimin e qartë të këtyre elementeve, menaxhimi i zonave mund të mbetet i orientuar vetëm drejt përcaktimit formal të statusit të mbrojtjes, pa siguruar mbrojtjen aktive të llojeve të shpendëve dhe habitateve të tyre.
Kjo problematikë ndikon gjithashtu në përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe raportimit ndërkombëtar për biodiversitetin. Mungesa e një sistemi të plotë dhe të harmonizuar për SPA-të vështirëson sigurimin e informacionit të nevojshëm mbi statusin e ruajtjes së llojeve, efektivitetin e masave të menaxhimit dhe progresin në zbatimin e kërkesave të Direktivës së Shpendëve.
Për pasojë, mangësitë në rregullimin e procedurave për krijimin, shpalljen dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët mund të kufizojnë efektivitetin e masave për mbrojtjen e llojeve të shpendëve të egër, të ndikojnë në ruajtjen e habitateve me rëndësi ekologjike dhe të krijojnë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit.

- **mungesën e një kuadri të plotë për rregullimin e introduktimit të llojeve jo-vendase dhe menaxhimin e ndikimeve të tyre mbi biodiversitetin;**

Problematika lidhet me mungesën e një kuadri të plotë dhe të integruar ligjor për parandalimin, kontrollin dhe menaxhimin e introduktimit të llojeve jo-vendase në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për vlerësimin dhe reduktimin e ndikimeve që këto lloje mund të shkaktojnë mbi biodiversitetin vendas. Kuadri aktual ligjor për mbrojtjen e faunës së egër nuk përmban dispozita të mjaftueshme dhe të detajuara që të rregullojnë në mënyrë të qartë procedurat, kriteret dhe përgjegjësitë institucionale për autorizimin, kontrollin dhe monitorimin e introduktimit të llojeve jo-vendase.
Introduktimi i llojeve jo-vendase, veçanërisht kur nuk shoqërohet me një vlerësim paraprak të rrezikut, mund të sjellë pasoja të rëndësishme për ekosistemet natyrore, përfshirë konkurrencën me llojet vendase, ndryshimin e strukturës dhe funksionimit të habitateve, transmetimin e sëmundjeve, si dhe ndikimin negativ në popullatat e llojeve vendase. Në mungesë të mekanizmave të qartë për vlerësimin e ndikimit dhe menaxhimin e këtyre rasteve, institucionet përgjegjëse kanë kufizime në aftësinë për të parandaluar ose ndërhyrë në kohë ndaj kërcënimeve që mund të paraqesin llojet jo-vendase.
Mungesa e procedurave të standardizuara për autorizimin e introduktimit të llojeve jo-vendase krijon gjithashtu vështirësi në garantimin e një procesi të kontrolluar dhe të bazuar në kritere shkencore. Nuk janë të përcaktuara në mënyrë të mjaftueshme elementet që duhet të vlerësohen përpara lejimit të një introduktimi, si qëllimi i introduktimit, origjina e llojit, karakteristikat biologjike, potenciali invaziv, ndikimi i mundshëm mbi llojet dhe habitatet vendase, si dhe masat parandaluese dhe monitoruese që duhet të zbatohen.
Një tjetër aspekt i rëndësishëm lidhet me mungesën e një ndarjeje të qartë të përgjegjësive ndërmjet institucioneve që kanë rol në administrimin e biodiversitetit, kontrollin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në natyrë, monitorimin e gjendjes së llojeve dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura. Mungesa e procedurave të koordinuara për shkëmbimin e informacionit dhe raportimin e rasteve të introduktimit të llojeve jo-vendase mund të çojë në reagime të vonuara dhe në vështirësi për ndërmarrjen e masave korrigjuese.
Problematika lidhet gjithashtu me nevojën për përafrimin e kuadrit kombëtar me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe angazhimet ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit, të cilat kërkojnë masa për parandalimin e futjes dhe kontrollin e përhapjes së llojeve që mund të kërcënojnë ekosistemet vendase. Një kuadër më i qartë ligjor do të mundësonte një qasje parandaluese dhe jo vetëm reaguese, duke forcuar kapacitetet institucionale për menaxhimin e rreziqeve që lidhen me llojet jo-vendase.
Për pasojë, mungesa e një sistemi të plotë për rregullimin e introduktimit të llojeve jo-vendase dhe menaxhimin e ndikimeve të tyre mund të ndikojë negativisht në ruajtjen e biodiversitetit, në mbrojtjen e llojeve dhe habitateve vendase, si dhe në efektivitetin e masave të ndërmarra për menaxhimin e qëndrueshëm të faunës së egër. Plotësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë është i nevojshëm për të siguruar parandalimin e rreziqeve ekologjike, rritjen e kontrollit institucional dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga acquis i Bashkimit Evropian dhe konventat ndërkombëtare për biodiversitetin.

- **mangësitë në përcaktimin e procedurave për përjashtimet nga masat e mbrojtjes së shpendëve të egër;**

Problematika lidhet me mungesën e një kuadri të plotë dhe të detajuar ligjor për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe përgjegjësive institucionale që lidhen me dhënien e përjashtimeve nga masat e mbrojtjes së shpendëve të egër. Kuadri aktual ligjor përcakton masat e përgjithshme për mbrojtjen e llojeve të shpendëve të egër, por nuk parashikon në mënyrë të mjaftueshme procedura të qarta dhe të standardizuara për rastet kur mund të lejohet përjashtimi nga këto masa, në përputhje me kushtet dhe kufizimet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.
Përjashtimet nga masat e mbrojtjes për shpendët e egër përbëjnë raste të veçanta që duhet të autorizohen vetëm kur plotësohen kushte të përcaktuara qartë dhe kur nuk ekziston një alternativë tjetër e përshtatshme. Në mungesë të kritereve të detajuara ligjore, mund të krijohen

paqartësi në interpretimin dhe zbatimin e dispozitave nga institucionet përgjegjëse, duke ndikuar në garantimin e një qasjeje të unifikuar dhe të bazuar në evidencë shkencore.
Mungesa e procedurave të standardizuara për aplikimin, vlerësimin dhe miratimin e përjashtimeve krijon vështirësi në përcaktimin e elementeve që duhet të dokumentohen dhe analizohen përpara marrjes së një vendimi. Nuk janë të përcaktuara në mënyrë të plotë kërkesat lidhur me arsyetimin e përjashtimit, të dhënat shkencore që duhet të paraqiten, ndikimin e mundshëm mbi popullatat e shpendëve, masat parandaluese dhe monitorimin e rezultateve pas zbatimit të përjashtimit.
Një tjetër problem lidhet me mungesën e një mekanizmi të qartë për monitorimin dhe raportimin e rasteve të përjashtimeve të dhëna. Pa një sistem të përcaktuar për mbledhjen e informacionit mbi numrin e përjashtimeve, arsyet e dhënies së tyre, zonat ku zbatohen dhe rezultatet e monitorimit, bëhet e vështirë të vlerësohet ndikimi i këtyre masave dhe nëse ato janë zbatuar në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me objektivat e ruajtjes së llojeve.
Kjo problematikë ndikon gjithashtu në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Direktiva e Shpendëve 2009/147/KE, e cila kërkon që çdo përjashtim nga masat e mbrojtjes të jetë i kufizuar, i justifikuar, i kontrollueshëm dhe i raportueshëm. Mungesa e një kuadri të plotë procedural mund të krijojë vështirësi në sigurimin e përputhshmërisë së praktikave kombëtare me standardet evropiane dhe në garantimin e një niveli të lartë mbrojtjeje për llojet e shpendëve të egër.
Për pasojë, mungesa e procedurave të qarta dhe të harmonizuara për përjashtimet nga masat e mbrojtjes së shpendëve të egër mund të ndikojë në efektivitetin e sistemit të mbrojtjes së këtyre llojeve, të krijojë pasiguri në zbatimin e ligjit dhe të vështirësojë kontrollin institucional mbi aktivitetet që mund të ndikojnë në popullatat e shpendëve. Plotësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë është i nevojshëm për të siguruar një proces transparent, të bazuar në të dhëna shkencore dhe në përputhje me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian.

- **mungesën e një kuadri të plotë dhe të harmonizuar për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike;**

Problematika lidhet me mungesën e një kuadri të plotë, të qartë dhe të harmonizuar ligjor për rregullimin e procedurave të autorizimit, funksionimit, kontrollit dhe inspektimit të kopshteve zoologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kuadri aktual ligjor nuk parashikon në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat dhe procedurat që duhet të përmbushen nga subjektet që mbajnë kafshë të egra në ambiente të kontrolluara, duke krijuar boshllëqe në lidhje me kushtet e licencimit, kriteret teknike të funksionimit, monitorimin dhe mbikëqyrjen institucionale të këtyre strukturave.
Funksionimi i kopshteve zoologjike kërkon një qasje të integruar që të garantojë njëkohësisht mbrojtjen e faunës së egër, mirëqenien e kafshëve të mbajtura në robëri, ruajtjen e llojeve dhe kontrollin e aktiviteteve që lidhen me mbajtjen, ekspozimin dhe administrimin e tyre. Në mungesë të kërkesave të detajuara ligjore, mund të krijohen paqartësi lidhur me standardet minimale që duhet të plotësojnë këto struktura, përfshirë kushtet e strehimit, ushqyerjes, kujdesit veterinar, menaxhimit të koleksioneve të kafshëve dhe masave për parandalimin e ndikimeve negative mbi biodiversitetin.
Mungesa e procedurave të qarta për autorizimin dhe vlerësimin paraprak të kushteve të funksionimit të kopshteve zoologjike krijon vështirësi në garantimin që këto struktura të plotësojnë standardet e nevojshme përpara fillimit të veprimtarisë. Nuk janë të përcaktuara në mënyrë të plotë elementet që duhet të vlerësohen gjatë procesit të autorizimit, si përshtatshmëria e ambienteve, kapacitetet teknike dhe profesionale, masat për mirëqenien e kafshëve, dokumentacioni për origjinën ligjore të ekzemplarëve dhe programet për edukimin, ruajtjen dhe ndërgjegjësimin e publikut.
Një problem tjetër lidhet me mungesën e një sistemi të qartë dhe të unifikuar për kontrollin dhe inspektimin periodik të kopshteve zoologjike. Pa përcaktimin e qartë të kompetencave institucionale, procedurave të inspektimit, elementeve që duhet të kontrollohen dhe mënyrës së

raportimit të rezultateve, ekziston rreziku që zbatimi i kërkesave ligjore të mos monitorohet në mënyrë efektive. Kjo mund të ndikojë në identifikimin në kohë të problematikave që lidhen me kushtet e mbajtjes së kafshëve, shëndetin dhe sigurinë e tyre, si dhe në marrjen e masave korrigjuese. Problematika lidhet gjithashtu me nevojën për përafrimin e legjislacionit kombëtar me kërkesat e Bashkimit Evropian, veçanërisht me dispozitat e Direktivës 1999/22/KE për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshte zoologjike. Kjo Direktivë kërkon që kopshtet zoologjike të autorizohen, kontrollohen dhe të zbatojnë masa për ruajtjen e llojeve, edukimin e publikut dhe sigurimin e standardeve të përshtatshme të mirëqenies së kafshëve. Mungesa e një kuadri të plotë procedural kufizon mundësinë për të garantuar zbatimin e këtyre kërkesave në praktikë. Për pasojë, mungesa e një kuadri të harmonizuar për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen e kafshëve të egra të mbajtura në ambiente të kontrolluara, në garantimin e standardeve të mirëqenies së tyre dhe në përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së faunës së egër. Plotësimi i kuadrit ligjor në këtë fushë është i nevojshëm për të siguruar një sistem transparent autorizimi, kontrolli dhe monitorimi, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe objektivat e ruajtjes së biodiversitetit.

Shkaqet kryesore të kësaj problematike lidhen me:

- fragmentimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e mbrojtjes së faunës së egër;
- mungesën e përafrimit të plotë të kuadrit kombëtar me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egër" dhe Direktivën 1999/22/KE "Për kopshtet zoologjike";
- kapacitetet e kufizuara teknike dhe institucionale për mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave;
- mungesën e procedurave dhe mekanizmave të unifikuar për koordinimin ndërinstitucional, shkëmbimin e informacionit dhe zbatimin e masave të menaxhimit.

Pasojat kryesore të problematikave të identifikuara lidhen me dobësimin e efektivitetit të sistemit të mbrojtjes dhe menaxhimit të faunës së egër, vështirësitë në zbatimin e masave të ruajtjes dhe kufizimet në përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e biodiversitetit. Këto problematika kanë pasoja të drejtpërdrejta në zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen e faunës së egër, në cilësinë e monitorimit dhe raportimit, si dhe në aftësinë e institucioneve përgjegjëse për të përmbushur detyrimet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Mungesa e një sistemi të plotë dhe të standardizuar për monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi faunën e egër kufizon mundësinë e institucioneve përgjegjëse për të disponuar informacion të saktë, të përditësuar dhe të krahasueshëm mbi gjendjen e llojeve dhe habitateve të tyre. Për pasojë, vendimmarrja për përcaktimin e prioriteteve të ruajtjes, hartimin e masave mbrojtëse dhe vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve mund të mos bazohet në të dhëna të plota dhe të standardizuara.

Mangësitë në procedurat për krijimin, shpalljen dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA) mund të ndikojnë në identifikimin, mbrojtjen dhe administrimin efektiv të zonave me rëndësi të veçantë për ruajtjen e shpendëve të egër. Këto mangësi mund të krijojnë vështirësi në zbatimin e masave të ruajtjes, monitorimin e statusit të llojeve dhe përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Direktiva 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egër".

Mungesa e një kuadri të plotë për menaxhimin e llojeve jo-vendase rrit rrezikun e introduktimit dhe përhapjes së llojeve që mund të shkaktojnë ndikime negative mbi biodiversitetin vendas,

duke ndikuar në strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve, në konkurrencën me llojet vendase dhe në gjendjen e habitateve natyrore.

Mungesa e procedurave të qarta dhe të standardizuara për përjashtimet nga masat e mbrojtjes së shpendëve të egër mund të krijojë pasiguri në zbatimin e legjislacionit, interpretime të ndryshme nga institucionet përgjegjëse dhe vështirësi në garantimin që përjashtimet të jenë të justifikuara shkencërisht, proporcionale dhe të monitorueshme.

Mangësitë në kuadrin ligjor për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike mund të ndikojnë në kontrollin efektiv të këtyre strukturave, në garantimin e standardeve për mirëqenien e kafshëve të egra të mbajtura në ambiente të kontrolluara dhe në zbatimin e kërkesave për ruajtjen e llojeve.

Në nivel institucional, mungesa e procedurave të unifikuara, ndarjes së qartë të përgjegjësive dhe mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional mund të sjellë fragmentim të informacionit, vështirësi në shkëmbimin e të dhënave, mbivendosje ose boshllëqe në zbatimin e kompetencave dhe përdorim joefektiv të burimeve administrative dhe teknike.

Në nivel strategjik, këto problematika ndikojnë në aftësinë e institucioneve për të planifikuar dhe zbatuar politika efektive për mbrojtjen e faunës së egër, për të vlerësuar progresin në ruajtjen e biodiversitetit dhe për të përmbushur detyrimet që burojnë nga acquis i Bashkimit Evropian, konventat ndërkombëtare dhe objektivat kombëtare për mbrojtjen e natyrës.

Problemi ka shtrirje kombëtare dhe prek të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me intensitet më të lartë në zonat me rëndësi të veçantë për faunën e egër, përfshirë Zonat e Mbrojtura dhe habitatet kritike të shpendëve të egër. Ai prek institucionet publike përgjegjëse për mjedisin, zonat e mbrojtura dhe inspektimin, subjektet private që ushtrojnë veprimtari të lidhura me faunën e egër, organizatat e shoqërisë civile, komunitetin shkencor dhe komunitetet lokale.

Grupet e prekura dhe mënyra e ndikimit

- **Institucionet qeveritare (ministria përgjegjëse për mjedisin, AKZM, inspektoratet, njësitë vendore):**Preken për shkak të mungesës së qartësisë në ndarjen e kompetencave, vështirësive në koordinim dhe mungesës së të dhënave të unifikuara për vendimmarrje dhe raportim. Kjo ul efektivitetin e zbatimit të politikave mjedisore dhe rrit barrën administrative.
- **Subjektet private (kopshte zoologjike, operatorë turistikë, veçanërisht në ekoturizëm):**Preken nga mungesa e rregullave të qarta dhe të harmonizuara për autorizim, funksionim dhe inspektim, duke krijuar pasiguri juridike dhe vështirësi në planifikimin e veprimtarisë ekonomike.
- **Shoqëria civile dhe organizatat mjedisore:** Preken për shkak të kufizimeve në aksesin ndaj të dhënave të besueshme dhe të standardizuara mbi **faunën e egër**, gjë që ndikon në aftësinë për monitorim të pavarur dhe advokim të politikave.
- **Komuniteti shkencor dhe akademik:** Preket nga mungesa e një baze të centralizuar dhe të krahasueshme të të dhënave për **faunën e egër**, duke kufizuar kërkimin shkencor dhe analizat afatgjata.
- **Qytetarët dhe komunitetet lokale:** Preken në mënyrë indirekte përmes degradimit të mundshëm të habitateve natyrore, reduktimit të vlerave të ekosistemeve dhe kufizimit të përfitimeve ekonomike nga ekoturizmi dhe shërbimet e ekosistemit.

Problemi vlerësohet se mund të trajtohet në mënyrë efektive përmes ndërhyrjes për të forcuar koordinimin institucional dhe për të siguruar përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian, si dhe për të përmirësuar sistemin e monitorimit, raportimit dhe kontrollit të faunës së egër.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme për të adresuar boshllëqet dhe paplotësitë e identifikuara në kuadrin ligjor ekzistues, të cilat kufizojnë zbatimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të kërkesave për mbrojtjen e faunës së egër dhe të habitateve të saj. Kuadri aktual nuk rregullon në mënyrë të plotë disa elemente të rëndësishme që lidhen me mbrojtjen e shpendëve të egër, përcaktimin dhe administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura për shpendët, zbatimin e masave të posaçme për ruajtjen e habitateve të tyre, kushtet për dhënien e përjashtimeve nga masat mbrojtëse, si dhe procedurat për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtyre përjashtimeve.
Gjithashtu, nevojitet rregullimi më i qartë i procedurave për introduktimin e llojeve jo-vendase, me qëllim parandalimin e ndikimeve të mundshme negative mbi florën, faunën dhe biodiversitetin vendase. Mungesa e kërkesave të detajuara për vlerësimin dhe autorizimin e këtyre veprimtarive mund të kufizojë aftësinë e institucioneve përgjegjëse për të identifikuar dhe parandaluar në kohë rreziqet që mund të cenojnë ekuilibrin ekologjik dhe statusin e ruajtjes së llojeve vendase.
Ndërhyrja është gjithashtu e nevojshme për të krijuar një kuadër më të plotë për autorizimin, funksionimin, monitorimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike. Mungesa e përcaktimit të qartë të kushteve dhe standardeve për ushtrimin e kësaj veprimtarie mund të krijojë paqartësi në zbatimin e kërkesave që lidhen me ruajtjen e biodiversitetit, mirëqenien dhe kujdesin ndaj kafshëve, sigurinë e publikut, parandalimin e arratisjes së kafshëve dhe shmangien e rreziqeve ekologjike ndaj faunës vendase. Për këtë arsye, kërkohet përcaktimi i procedurave të qarta për dhënien, pezullimin dhe shfuqizimin e autorizimit, si dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe përgjegjësisë administrative.

Po ashtu, ndërhyrja synon të qartësojë ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive ndërmjet institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, administrimin dhe kontrollin e faunës së egër, përfshirë rolin e njësive të vetëqeverisjes vendore në autorizimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike. Qartësimi i përgjegjësive institucionale është i nevojshëm për të shmangur paqartësitë, mbivendosjen ose mungesën e përgjegjësisë në zbatim dhe për të siguruar një kontroll më efektiv të përmbushjes së kërkesave ligjore.

Ndërhyrja lidhet gjithashtu me nevojën për forcimin e mekanizmave të monitorimit, mbledhjes, administrimit dhe raportimit të të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër. Mungesa e standardizimit dhe e procedurave të unifikuara për administrimin e informacionit mund të kufizojë mundësinë për të vlerësuar gjendjen e ruajtjes së llojeve, për të identifikuar në kohë

kërcënimet dhe për të orientuar masat mbrojtëse mbi bazën e të dhënave shkencore dhe të krahasueshme.

Në këtë kuadër, ndërhyrja është e nevojshme edhe për të siguruar përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egër" dhe Direktivën 1999/22/KE "Për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshtet zoologjike". Përmes plotësimit dhe qartësimit të dispozitave ekzistuese synohet krijimi i një kuadri më koherent, të zbatueshëm dhe efektiv, që garanton standarde më të larta për mbrojtjen e faunës së egër, ruajtjen e habitateve dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Shkalla e ndërhyrjes konsiston në ndërhyrje të kufizuar ligjore, përmes ndryshimeve dhe shtesave në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar, me fokus në rritjen e koherencës së kuadrit rregullator, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe adresimin e fushave ku konstatohet mungesë ose paplotësi e rregullimit ligjor. Ndërhyrja nuk synon miratimin e një ligji të ri, por përmirësimin e kuadrit ekzistues ligjor përmes ndryshimeve dhe shtesave të nevojshme për të siguruar zbatim më efektiv dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga acquis i Bashkimit Evropian.

Ndërhyrja e propozuar është në përputhje me objektivat strategjikë të qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së biodiversitetit dhe integrimit evropian, siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE), miratuar me VKM nr. 88, datë 22.02.2023, si dhe në Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, miratuar me VKM nr. 31, datë 20.01.2016.
Në kuadër të SKZHIE 2022–2030, ndërhyrja kontribuon në forcimin e qeverisjes mjedisore, përmirësimin e zbatimit dhe kontrollit të legjislacionit mjedisor, si dhe në përshpejtimin e procesit të përafrimit të kuadrit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian. Në veçanti, ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e faunës së egër, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kërkesave ligjore.

Në lidhje me Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, ndërhyrja mbështet objektivat për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, përmirësimin e njohurive dhe të dhënave mbi gjendjen e specieve dhe habitateve, si dhe forcimin e instrumenteve të monitorimit dhe menaxhimit të faunës së egër.
Ndërhyrja lidhet gjithashtu me angazhimet e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike", përmes përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me Direktivën 2009/147/KE "Për ruajtjen e shpendëve të egër" dhe Direktivën 1999/22/KE "Për kopshtet zoologjike". Në funksion të arritjes së këtyre objektivave strategjikë, gjatë zbatimit të kuadrit ekzistues janë ndërmarrë një sërë masash për forcimin e mbrojtjes së faunës së egër dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale.
Kuadri ekzistues ligjor për mbrojtjen e faunës së egër bazohet në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", i ndryshuar, i cili ka krijuar bazën ligjore për ruajtjen, menaxhimin dhe mbrojtjen e specieve të faunës së egër, përcaktimin e masave mbrojtëse dhe përgjegjësive institucionale.

Gjatë zbatimit të këtij kuadri janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm, përfshirë:

1. Zgjerimi dhe konsolidimi i rrjetit të zonave të mbrojtura tokësore, bregdetare dhe detare, me qëllim ruajtjen e habitateve dhe llojeve me rëndësi për biodiversitetin, si dhe forcimin e strukturave përgjegjëse për administrimin dhe monitorimin e tyre.

Gjatë viteve të fundit, është zgjeruar rrjeti i zonave të mbrojtura tokësore dhe detare, duke përfshirë zona me rëndësi të veçantë për ruajtjen e habitateve, llojeve të faunës së egër, ligatinave, ekosistemeve pyjore, zonave malore, lumenjve dhe ekosistemeve bregdetare. Sipas informacionit të publikuar në kuadër të projektit EU4Nature, sipërfaqja e zonave të mbrojtura në Shqipëri ka arritur rreth 21% të territorit kombëtar, krahasuar me më pak se 6% në vitin 2005. Zgjerimi i këtij rrjeti ka krijuar një bazë territoriale për ruajtjen e habitateve dhe kufizimin e veprimtarive që mund të ndikojnë negativisht në biodiversitet. [1]
Krahas zgjerimit të sipërfaqes së mbrojtur, janë krijuar dhe konsoliduar strukturat përgjegjëse për administrimin e zonave të mbrojtura, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe administratat rajonale. Këto struktura kanë përgjegjësi për zbatimin e planeve të menaxhimit, monitorimin e biodiversitetit, kontrollin e territorit, administrimin e vizitorëve dhe bashkëpunimin me komunitetet lokale.
Mund të shtoni:

2. Hartimi dhe përditësimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura
Për një pjesë të zonave të mbrojtura janë hartuar ose janë në proces përditësimi planet e menaxhimit. Këto plane përcaktojnë objektivat e ruajtjes, vlerat natyrore të zonës, kërcënimet kryesore, masat e nevojshme për mbrojtjen e habitateve dhe specieve, përgjegjësitë institucionale, aktivitetet e monitorimit dhe mënyrën e përfshirjes së komuniteteve lokale.
Në kuadër të EU4Nature, janë zhvilluar ose përditësuar plane menaxhimi për disa zona prioritare, duke u orientuar drejt kërkesave të rrjetit Natura 2000. Projekti ka përfshirë 10 zona pilot, përfshirë Parkun Kombëtar të Lumit Vjosa, Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës–Dangëlli", Parkun Kombëtar "Lurë–Mali i Dejës", Parkun Kombëtar "Shebenik", Parkun Natyror "Zagori", Luginën e Shalës dhe Parkun Natyror "Porto Palermo". [2]
Planet e menaxhimit janë të rëndësishme sepse e kalojnë mbrojtjen nga një regjim kryesisht formal, i bazuar në shpalljen e zonës, në një proces konkret të planifikimit të masave, monitorimit të rezultateve dhe vlerësimit të efektivitetit të menaxhimit.
Mund të shtoni:

3. Monitorimi i faunës së egër dhe mbledhja e të dhënave
Janë zhvilluar praktika të monitorimit të faunës së egër përmes vëzhgimeve në terren, regjistrimit të pranisë dhe shpërndarjes së llojeve, vlerësimit të gjendjes së habitateve dhe përgatitjes së raporteve periodike. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka publikuar raporte dhe materiale monitorimi për faunën e egër për periudha të ndryshme, përfshirë raporte mbi monitorimin e llojeve dhe të dhënat e mbledhura në kuadër të sistemit të monitorimit të faunës. [3]
Në kuadër të EU4Nature janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kapaciteteve teknike të administratave të zonave të mbrojtura. Janë siguruar kamera monitorimi për vëzhgimin e

[1] EU for Nature | United Nations Development Programme

[2] EU for Nature | United Nations Development Programme

[3] Fauna e egër - Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

faunës, dronë për monitorimin e zonave të gjera ose të vështira për t'u aksesuar, pajisje për monitorimin e ekosistemeve ujore dhe mjete për mbështetjen e kontrollit në terren.
Gjithashtu, janë identifikuar specie treguese në zonat pilot, me qëllim krijimin e treguesve për vlerësimin e gjendjes së biodiversitetit dhe matjen e ndryshimeve në kohë.
Megjithatë, kjo pjesë duhet të paraqitet me kujdes: ekzistojnë praktika dhe të dhëna monitorimi, por kjo nuk do të thotë se është krijuar tashmë një sistem i plotë, i unifikuar dhe i standardizuar në nivel kombëtar. Pikërisht ky mbetet një nga boshllëqet që synon të adresojë ndërhyrja ligjore.[4]

4. Moratoriumet e gjuetisë (miratimi dhe zbatimi i masave të përkohshme kufizuese)
Moratoriumi i gjuetisë është përdorur si instrument ligjor për kufizimin e ushtrimit të gjuetisë dhe reduktimin e presionit të drejtpërdrejtë mbi popullatat e faunës së egër.

Qëllimet kryesore të moratoriumit kanë qenë:

- kufizimi i vrasjes dhe kapjes së llojeve të faunës së egër;
- krijimi i kushteve për rikuperimin e popullatave të llojeve të dëmtuara ose të rrezikuara;
- reduktimi i gjuetisë së paligjshme dhe i përdorimit të mjeteve të ndaluara;
- krijimi i një periudhe gjatë së cilës mund të përmirësohet monitorimi i faunës dhe të vlerësohet gjendja e popullatave;
- forcimi i kontrollit institucional dhe përmirësimi i kuadrit rregullator për administrimin e gjuetisë.

Moratoriumet kanë qenë masa të përkohshme mbrojtëse, dhe nuk kanë zgjidhur në mënyrë të plotë problemet e mbrojtjes së faunës. Efektiviteti i tyre ka qenë i lidhur edhe me nivelin e kontrollit në terren, kapacitetet e strukturave përgjegjëse dhe zbatimin e masave kundër gjuetisë së paligjshme.

5. Hartimi i masave dhe planeve të veprimit për specie të veçanta
Për lloje të caktuara me rëndësi të veçantë për ruajtjen janë ndërmarrë masa specifike, të cilat mund të përfshijnë:

- identifikimin e zonave të shumimit, ushqimit dhe pushimit;
- monitorimin e popullatave;
- mbrojtjen e habitateve kryesore;
- kufizimin e shqetësimeve nga aktivitetet njerëzore;
- masa për parandalimin e dëmtimit ose vrasjes së llojeve;
- ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale;
- bashkëpunimin me organizata shkencore dhe organizata të shoqërisë civile.

Këto masa janë të rëndësishme sepse disa specie kërkojnë ndërhyrje të posaçme dhe nuk mund të mbrohen në mënyrë të mjaftueshme vetëm përmes masave të përgjithshme të ligjit.

6. Vlerësimi i efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura
Një zhvillim më i ri është përdorimi i instrumenteve për vlerësimin e efektivitetit të menaxhimit. Në kuadër të EU4Nature, për 10 zona prioritare janë kryer vlerësime përmes instrumentit Management Effectiveness Tracking Tool – METT.[5]
Ky instrument vlerëson, ndër të tjera:

- qartësinë e objektivave të zonës së mbrojtur;
- kapacitetet njerëzore dhe financiare;
- ekzistencën dhe zbatimin e planeve të menaxhimit;

[4] EU for Nature | United Nations Development Programme

[5] EU for Nature | United Nations Development Programme

- monitorimin e biodiversitetit;
- mekanizmat e kontrollit;
- bashkëpunimin me komunitetet lokale;
- efektivitetin e masave të ruajtjes.

7. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale të strukturave përgjegjëse për administrimin e zonave të mbrojtura

Janë zhvilluar trajnime për administratat e zonave të mbrojtura dhe strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe menaxhimin e biodiversitetit. Trajnimet kanë përfshirë çështje që lidhen me:

- planifikimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit;
- monitorimin e biodiversitetit;
- përdorimin e pajisjeve teknologjike;
- menaxhimin e vizitorëve;
- bashkëpunimin me komunitetet lokale;
- zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e natyrës.

Në kuadër të EU4Nature është krijuar edhe një platformë elektronike trajnimi për stafin e zonave të mbrojtura, me module mbi menaxhimin, monitorimin e biodiversitetit dhe bashkëpunimin me palët e interesuara.

8. Përafrimi me acquis të Bashkimit Evropian

Janë ndërmarrë hapa për vlerësimin e nivelit të përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës, veçanërisht me Direktivën e Shpendëve dhe Direktivën e Habitateve.
Në kuadër të EU4Nature është mbështetur përgatitja e materialeve teknike dhe tabelave të referencës për kërkesat e direktivave, duke përfshirë punën mbi anekset dhe kërkesat që lidhen me llojet dhe habitatet. [6]
Kjo punë ka shërbyer për:

- identifikimin e dispozitave që janë përafruar;
- evidentimin e boshllëqeve në legjislacion;
- përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme ligjore dhe nënligjore;
- përgatitjen e bazës teknike për zhvillimin e rrjetit Natura 2000. [7]

9. Restaurimi i habitateve dhe zbatimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë

Në disa zona janë ndërmarrë masa për restaurimin e habitateve të dëmtuara. Për shembull, në kuadër të Planit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa janë ndërmarrë ndërhyrje për restaurimin e habitatit breglumor dhe mbjelljen e bimësisë vendase. [8]

Këto masa kontribuojnë në:

- përmirësimin e cilësisë së habitateve;
- krijimin e kushteve për ushqim, shumim dhe strehim të faunës;
- reduktimin e degradimit dhe fragmentimit të habitateve;
- rritjen e qëndrueshmërisë së ekosistemeve ndaj ndryshimeve klimatike.

[6] EU for Nature | United Nations Development Programme

[7] EU for Nature | United Nations Development Programme

[8] EU for Nature | United Nations Development Programme

10. Përfshirja e komuniteteve lokale, akademisë dhe shoqërisë civile

Mbrojtja e faunës nuk është trajtuar vetëm përmes masave administrative. Janë zhvilluar forma bashkëpunimi me komunitetet lokale, organizatat e shoqërisë civile, universitetet dhe ekspertët shkencorë.

Kjo ka përfshirë:

- konsultime për planet e menaxhimit;
- përfshirjen e komuniteteve në veprimtari ruajtjeje;
- projekte për restaurimin e habitateve;
- programe edukimi dhe ndërgjegjësimi;
- angazhimin e të rinjve në monitorimin e biodiversitetit.

Në kuadër të programit Youth4Nature, të rinj janë angazhuar pranë strukturave të zonave të mbrojtura për të kontribuar në monitorimin e biodiversitetit dhe aktivitetet e edukimit mjedisor.[9]

Gjithashtu, analizat e kryera në kuadër të asistencës teknike, përfshirë mbështetjen e ofruar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) nëpërmjet projektit "EU for Nature", si dhe vlerësimet e realizuara në kuadër të proceseve të integrimit evropian dhe raportimeve kombëtare për biodiversitetin, kanë evidentuar nevojën për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e faunës së egër dhe përafrimin e tij me standardet e Bashkimit Evropian.

Raportet dhe analizat teknike të realizuara në këtë kuadër kanë evidentuar disa fusha kryesore ku kërkohet forcimi i kuadrit ekzistues, përfshirë nevojën për përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit të gjendjes së llojeve dhe habitateve, rritjen e cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave mjedisore, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përcaktimin më të qartë të roleve dhe përgjegjësive të institucioneve zbatuese.

Në veçanti, vlerësimet teknike kanë nënvizuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave më të strukturuar për mbledhjen, administrimin, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave mbi biodiversitetin dhe faunën e egër, me qëllim sigurimin e informacionit të besueshëm për hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve të bazuara në evidencë shkencore. Gjithashtu, është evidentuar nevoja për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e procedurave të zbatimit, kontrollit dhe raportimit, në përputhje me kërkesat që burojnë nga acquis i Bashkimit Evropian.

Megjithëse kuadri ekzistues ligjor ka krijuar bazën e nevojshme për mbrojtjen e faunës së egër, zbatimi praktik dhe gjetjet e evidentuara nga këto analiza kanë treguar nevojën për ndërhyrje të mëtejshme ligjore dhe institucionale, veçanërisht në drejtim të:

- forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit mbi gjendjen e specieve dhe habitateve, duke siguruar të dhëna të krahasueshme dhe të standardizuara;
- standardizimit të metodologjive për mbledhjen, përpunimin, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse;
- përmirësimit të koordinimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, zonat e mbrojtura, monitorimin dhe kontrollin e aktiviteteve që ndikojnë mbi faunën e egër;

[9] EU for Nature | United Nations Development Programme

- përditësimit dhe plotësimit të kuadrit nënligjor në përputhje me zhvillimet e reja ligjore dhe kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian;
- forcimit të procedurave për autorizimin, kontrollin, monitorimin dhe menaxhimin e aktiviteteve që lidhen me faunën e egër, përfshirë menaxhimin e kopshteve zoologjike, kontrollin e introduktimit të llojeve jo-vendase dhe zbatimin e masave të veçanta për mbrojtjen e shpendëve të egër.

Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet adresimi i mangësive të identifikuara gjatë zbatimit të kuadrit ekzistues dhe i rekomandimeve të dala nga analizat teknike dhe proceset e vlerësimit, duke përmirësuar mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe kontrollit, duke qartësuar përgjegjësitë institucionale dhe duke krijuar kushtet për një menaxhim më efektiv dhe të qëndrueshëm të faunës së egër dhe habitateve të saj, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe detyrimet ndërkombëtare në fushën e biodiversitetit.

.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi i përgjithshëm është që, deri në vitin 2028, kuadri ligjor dhe institucional për mbrojtjen, menaxhimin dhe monitorimin e faunës së egër të jetë funksional, i monitorueshëm dhe i përafruar me detyrimet përkatëse të Bashkimit Evropian.

Kjo politikë synon arritjen e objektivave të mëposhtme SMART në fushën e mbrojtjes së faunës së egër:

1. Harmonizimi i plotë i kuadrit të brendshëm rregullator me Direktivën 2009/147/KE dhe Direktivën 1999/22/KE deri në përfundim të periudhës afatmesme të zbatimit të politikës,brenda vitit;
2. Sigurimi i integrimit dhe operacionalizimit të 100% të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA) në kuadrin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe në instrumentet përkatëse të planifikimit dhe menaxhimit të territorit, brenda vitit 2028;
3. Sigurimi i formalizimit të ndarjes së kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe inspektimin e faunës së egër, brenda vitit 2027.
4. Sigurimi i funksionalizimit të një sistemi të standardizuar kombëtar për monitorimin dhe raportimin e faunës së egër, veçanërisht të shpendëve dhe habitateve të tyre, brenda vitit 2028, duke garantuar mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të standardizuara për 100% të grupeve të specieve dhe habitateve të përcaktuara në legjislacion;
5. Vendosja dhe zbatimi i nje metodologjie te unifikuar kombetare per monitorimin dhe raportimin e faunes se eger, perditesimi te pakten nje here ne vit i bazes kombetare te te dhenave dhe hartimi i te pakten nje raporti kombetar te monitorimit cdo vit, brenda vitit 2028;
6. Sigurimi i zbatimit të standardeve të unifikuara për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e 100% të kopshteve zoologjike, në përputhje me Direktivën 1999/22/KE, brenda vitit 2028.
7. Forcimi i kontrollit mbi introduktimin e llojeve jo-vendase, përmes vendosjes dhe zbatimit të procedurave të standardizuara për vlerësimin dhe miratimin e tyre, brenda vitit 2028, me synim reduktimin e rrezikut për faunën e egër dhe ekosistemet natyrore.

Objektivat e mësipërm synojnë adresimin e drejtpërdrejtë të problematikave të identifikuara në analizën e problemit, përkatësisht mangësive në përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian, mungesës së një sistemi të standardizuar të monitorimit dhe raportimit

të faunës së egër, paqartësive në ndarjen e përgjegjësive institucionale, si dhe nevojës për një kuadër më të plotë rregullator për administrimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët, kopshteve zoologjike dhe kontrollin e llojeve jo-vendase. Arritja e këtyre objektivave pritet të përmirësojë efektivitetin e zbatimit të legjislacionit, koordinimin ndërinstitucional dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian.

Kjo politikë synon arritjen e objektivave SMART në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të faunës së egër, përmes përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional, forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian dhe forcimit të masave për mbrojtjen dhe menaxhimin e llojeve dhe habitateve të tyre.
Objektivat specifikë të politikës janë:

- Përafrimi i kuadrit kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër me acquis të Bashkimit Evropian;
- Integrimi dhe operacionalizimi i Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA) në kuadrin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe në instrumentet përkatëse të planifikimit dhe menaxhimit;
- Standardizimi i monitorimit dhe raportimit kombëtar të faunës së egër;
- Formalizimi i ndarjes së kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin dhe inspektimin e faunës së egër;
- Përmirësimi i kuadrit për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike;
- Forcimi i kontrollit mbi introduktimin e llojeve jo-vendase.

Objektivat e mësipërm synojnë adresimin e drejtpërdrejtë të problematikave të identifikuara në analizën e problemit, konkretisht mangësive në përafrimin e kuadrit ligjor me acquis të Bashkimit Evropian, mungesës së një sistemi plotësisht të standardizuar të monitorimit dhe raportimit të faunës së egër, nevojës për forcimin e mbrojtjes dhe menaxhimit të shpendëve të egër dhe habitateve të tyre, përfshirë Zonat Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët, paqartësive në ndarjen e kompetencave institucionale, si dhe nevojës për përmirësimin e kuadrit për autorizimin, funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike dhe kontrollin e introduktimit të llojeve jo-vendase.

Arritja e këtyre objektivave pritet të përmirësojë efektivitetin e zbatimit të legjislacionit për faunën e egër, të rrisë cilësinë e të dhënave dhe raportimeve, të forcojë mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të tyre dhe të kontribuojë në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer nga Ministria përgjegjëse për mjedisin, janë shqyrtuar disa opsione politike për adresimin e problematikave të identifikuara në kuadër të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës, në lidhje me faunën e egër.

Opsioni i status quo-së (0):Ky opsion nënkupton ruajtjen e kuadrit ligjor ekzistues pa ndryshime.
Avantazhet:

- Nuk kërkon burime financiare apo administrative shtesë;

- Nuk sjell nevojë për ndryshime institucionale;
- Ruhet stabiliteti formal i kuadrit ligjor ekzistues në afat të shkurtër.

Disavantazhet:

- Nuk adreson boshllëqet ligjore ekzistuese;
- Vijon fragmentimi i dispozitave dhe paqartësia institucionale;
- Nuk siguron përafrim të plotë me Direktivën 2009/147/KE dhe 1999/22/KE;
- Mbetet i kufizuar sistemi i monitorimit dhe raportimit;
- Rrezikon mosplotësimin e detyrimeve të integrimit evropian (Kapitulli 27).

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues (**opsioni i preferuar**):Ky opsion parashikon rishikimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues për faunën e egër.

Avantazhet:

- Siguron përafrim më të plotë me acquis të BE-së në mënyrë proporcionale;
- Përmirëson kuadrin institucional dhe ndarjen e kompetencave;
- Forcon mekanizmat e monitorimit, raportimit dhe kontrollit;
- Rregullon SPA dhe menaxhimin e llojeve jo-vendase;
- Përmirëson funksionimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike;
- Mund të zbatohet më shpejt dhe me kosto të ulët krahasuar me ligj të ri.

Disavantazhet:

- Nuk krijon një rikonceptim tërësor të kuadrit ligjor;
- Kërkon ndërhyrje të shumta në dispozitat ekzistuese;
- Mund të ruajë pjesërisht strukturën ekzistuese të fragmentuar të ligjit.

Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri:Ky opsion parashikon krijimin e një kuadri tërësisht të ri ligjor për faunën e egër.

Avantazhet:

- Mundëson ristrukturim të plotë dhe koherent të kuadrit ligjor;
- Siguron harmonizim të plotë dhe sistematik me acquis të BE-së;
- Eliminon fragmentimin ekzistues normativ;
- Krijon bazë të re konceptuale dhe institucionale.

Disavantazhet:

- Proces i gjatë hartimi dhe miratimi;
- Kosto më të larta institucionale dhe administrative;
- Nevojë për riorganizim të gjerë institucional dhe përshtatje të sistemit ekzistues;
- Rrezik vonese në përmbushjen e detyrimeve të integrimit evropian.

Opsioni 3: Opsion jo-rregullator (forcim administrativ pa ndryshim ligjor):Ky opsion parashikon përmirësime përmes masave administrative pa ndryshime ligjore.

Avantazhet:

- Nuk kërkon ndryshime ligjore;
- Zbatim i shpejtë i masave administrative dhe udhëzimeve teknike;
- Mund të përmirësojë koordinimin institucional në afat të shkurtër;
- Kosto minimale financiare.

Disavantazhet:

- Nuk zgjidh boshllëqet strukturore ligjore;
- Nuk siguron përafrim të plotë me acquis të BE-së;
- Efekt i kufizuar në zbatimin afatgjatë;
- Nuk adreson paqartësitë në kompetenca dhe përgjegjësi;
- Nuk garanton standardizim të sistemit të monitorimit dhe raportimit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
    - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
    - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
    - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
    - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
    - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
    - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
    - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
    - *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Zbatimi i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, 'Për mbrojtjen e faunës së egër', i ndryshuar", synon forcimin e kuadrit ligjor kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër dhe përafrimin e tij me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat që lidhen me mbrojtjen e shpendëve të egër, menaxhimin e llojeve jo-vendase dhe invazive, mbrojtjen e habitateve të llojeve të faunës së egër, si dhe rregullimin dhe kontrollin e aktiviteteve që lidhen me mbajtjen dhe përdorimin e kafshëve të egra.

Ndërhyrja e propozuar pritet të ketë ndikime institucionale, ekonomike, sociale dhe mjedisore. Ndikimet kryesore lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator për mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, përmirësimin e kontrollit të llojeve të egra dhe invazive, rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së veprimtarive që lidhen me faunën e egër, si dhe krijimin e një kuadri më të qartë për institucionet dhe subjektet që lidhen me mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të faunës së egër.
Ndërkohë, zbatimi i projektligjit mbështetet kryesisht në strukturat dhe kapacitetet ekzistuese institucionale. Kostot e identifikuara lidhen me kostot operacionale të zbatimit dhe parashikohen të përballohen brenda fondeve të miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm, pa kërkuar fonde shtesë nga buxheti i shtetit. Në analizën e Biodiversitetit, këto kosto janë paraqitur për monitorimin, administrimin e zonave të mbrojtura dhe angazhimin e institucioneve përgjegjëse.

Analiza e ndikimeve është kryer duke identifikuar grupet e prekura, natyrën e ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, si dhe duke vlerësuar kostot dhe përfitimet e pritshme të ndërhyrjes.

Grupet kryesore të prekura nga ndërhyrja janë:

a) institucionet publike përgjegjëse për mjedisin, faunën e egër, biodiversitetin, zonat e mbrojtura, monitorimin dhe inspektimin;

b) njësitë e vetëqeverisjes vendore, veçanërisht ato që administrojnë ose kanë në territor zona me vlera të larta natyrore, habitate dhe popullata të rëndësishme të llojeve të faunës së egër;
c) administratat e zonave të mbrojtura, të cilat përfshihen në monitorimin, menaxhimin dhe raportimin mbi gjendjen e llojeve dhe habitateve të tyre;
ç) institucionet akademike dhe kërkimore, universitetet, qendrat kërkimore dhe ekspertët që zhvillojnë kërkime dhe monitorime në fushën e faunës së egër;
d) operatorët ekonomikë që lidhen me përdorimin, mbajtjen, transportin, tregtimin ose menaxhimin e kafshëve të egra dhe produkteve të tyre;
dh) operatorët e turizmit natyror dhe ekoturizmit, të cilët përfitojnë në mënyrë të tërthortë nga ruajtja e faunës së egër dhe habitateve natyrore;
e) komunitetet lokale dhe rurale, të cilat varen nga burimet natyrore për jetesë, punësim, aktivitete ekonomike tradicionale, turizëm dhe mirëqenie;
ë) shoqëria civile dhe organizatat mjedisore, të cilat kanë rol në monitorim, ndërgjegjësim, pjesëmarrje publike dhe kontroll shoqëror të zbatimit të politikave për mbrojtjen e natyrës.

Vlerësimi i ndikimit për institucionet akademike dhe kërkimore
Projektligji nuk parashikon detyrime të reja për institucionet akademike dhe kërkimore, universitetet, qendrat kërkimore apo ekspertët që zhvillojnë kërkime dhe monitorime në fushën e faunës së egër, përtej parashikimeve të kuadrit ligjor ekzistues. Përfshirja e tyre synon të mundësojë bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, monitorimit dhe shkëmbimit të të dhënave, pa krijuar detyrime të reja financiare apo administrative për këto subjekte. Për rrjedhojë, projektligji nuk sjell kosto shtesë të drejtpërdrejta për këtë kategori subjektesh.

Ndikimet institucionale
Projektligji nuk parashikon ndryshime në funksionet dhe kompetencat ekzistuese të institucioneve përgjegjëse për administrimin, monitorimin, mbrojtjen dhe kontrollin e faunës së egër, përtej kuadrit ligjor në fuqi.

Zbatimi i dispozitave të projektligjit do të mbështetet në strukturat dhe kapacitetet ekzistuese institucionale, pa parashikuar krijimin e strukturave të reja, shtimin e detyrave administrative apo nevojën për burime shtesë njerëzore, financiare dhe teknike.

Për rrjedhojë, projektligji nuk parashikon kosto administrative shtesë për institucionet publike. Kostot e lidhura me ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave ekzistuese mbulohen në kuadër të veprimtarisë së zakonshme të institucioneve përkatëse dhe nuk krijojnë efekte financiare shtesë si pasojë e projektligjit.

Ndikimet mbi njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe administratat e zonave të mbrojtura
Projektligji nuk parashikon ndryshime në funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të administratave të zonave të mbrojtura, përtej atyre të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Për rrjedhojë, këto struktura nuk ngarkohen me detyra të reja si rezultat i ndryshimeve të propozuara dhe nuk parashikohet rritje e ngarkesës administrative, nevojë për burime shtesë njerëzore, financiare apo teknike, ose kosto shtesë për zbatimin e projektligjit. Veprimtaritë që lidhen me administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e faunës së egër do të vijojnë të kryhen në përputhje me funksionet dhe kompetencat ekzistuese të këtyre strukturave.

Ndikimet ekonomike
Ndikimet ekonomike të projektligjit lidhen kryesisht me sektorët dhe subjektet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me faunën e egër, përfshirë turizmin natyror, ekoturizmin, pyjet, peshkimin, aktivitetet kërkimore, menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe aktivitetet që lidhen

me mbajtjen dhe përdorimin e kafshëve të egra. Ndërhyrja nuk synon të kufizojë aktivitetin ekonomik, por ta vendosë atë në një kuadër më të qartë, më transparent dhe më të parashikueshëm ligjor. Për operatorët ekonomikë, ndikimet pozitive lidhen me rritjen e sigurisë juridike, qartësimin e rregullave, përmirësimin e kontrollit dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteteve në përputhje me parimet e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në të njëjtën kohë, disa subjekte mund të përballen me një barrë të kufizuar administrative, të lidhur me dokumentimin, autorizimet, raportimin, kontrollin ose respektimin e kërkesave për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër. Në këtë fazë, këto kosto nuk mund të përllogariten në mënyrë të besueshme për shkak të mungesës së të dhënave të plota për numrin dhe kategoritë e subjekteve që do t'u nënshtrohen konkretisht detyrimeve, shpeshtësinë e procedurave dhe kohën administrative të nevojshme. Për këto arsye, ndikimet ekonomike mbi subjektet private trajtohen kryesisht në mënyrë cilësore dhe do të rivlerësohen gjatë zbatimit, pasi të jenë mbledhur të dhëna më të plota.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme pritet të jetë i kufizuar dhe kryesisht administrativ. Projektligji nuk parashikon vendosjen e taksave apo tarifave të reja të drejtpërdrejta për SME-të, por mund të krijojë detyrime të caktuara për përputhshmëri në rastet kur këto ndërmarrje ushtrojnë aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me faunën e egër. Për SME-të që operojnë në sektorë si turizmi natyror, ekoturizmi, aktivitetet kërkimore, menaxhimi i habitateve, aktivitetet zoologjike ose përdorimi i produkteve me origjinë nga fauna e egër, ndikimi kryesor lidhet me nevojën për të respektuar kërkesat ligjore dhe administrative.

Për të shmangur barrën e panevojshme rregullatore, aktet nënligjore dhe udhëzimet zbatuese duhet të parashikojnë procedura të thjeshta, proporcionale dhe të kuptueshme, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe subjektet me kapacitete të kufizuara administrative. Në afatmesëm dhe afatgjatë, qartësimi i rregullave mund të ketë ndikim pozitiv për SME-të, pasi rrit sigurinë juridike, përmirëson parashikueshmërinë e aktivitetit dhe krijon kushte më të favorshme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe aktiviteteve të ekonomisë së gjelbër.

Ndikimet mbi punësimin

Projektligji nuk parashikon krijimin e vendeve të reja të punës apo të strukturave të reja institucionale. Zbatimi i tij do të realizohet nëpërmjet organizimit dhe rishpërndarjes së detyrave brenda strukturave ekzistuese, veçanërisht për monitorimin e faunës së egër, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, raportimin dhe kontrollin mjedisor.

Për këto veprimtari, vlerësimi i kostos lidhet me kohën shtesë të angazhimit të stafit ekzistues që shkaktohet nga projektligji. Kjo kosto përllogaritet mbi bazën e numrit të punonjësve të përfshirë, ditëve ose orëve shtesë të punës dhe kostos për njësi kohe. Ndarja e angazhimit ekzistues nga ai shtesë dhe vlera përkatëse duhet të dokumentohen në analizën financiare, pavarësisht mbulimit të tyre brenda buxhetit të miratua

Burimet financiare të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të parashikuara do të mbulohen brenda tavaneve buxhetore të miratuara dhe nëpërmjet përdorimit të kapaciteteve dhe strukturave ekzistuese institucionale.

Ndikimet sociale

Ndikimet sociale të projektligjit lidhen kryesisht me komunitetet lokale dhe rurale, të cilat jetojnë pranë zonave me vlera të larta natyrore dhe varen nga burimet natyrore për të ardhurat, punësimin, turizmin, bujqësinë, pyjet dhe aktivitete të tjera tradicionale.Ndërhyrja pritet të ketë ndikim pozitiv mbi mirëqenien sociale, pasi mbrojtja e faunës së egër dhe habitateve natyrore kontribuon në mbrojtjen e bazës natyrore të jetesës së komuniteteve. Përmirësimi i menaxhimit të faunës së egër mund të ndikojë pozitivisht në cilësinë e mjedisit, zhvillimin e turizmit natyror, mundësitë për punësim lokal dhe ruajtjen e vlerave natyrore. Projektligji mund të ndikojë edhe

në barazinë territoriale, pasi zonat rurale dhe zonat me vlera të larta natyrore shpesh kanë nevojë për më shumë mbështetje institucionale, informacion dhe mundësi zhvillimi të qëndrueshëm.

Ndikimet mbi shëndetin publik

Ndikimet mbi shëndetin publik janë kryesisht të tërthorta.Mbrojtja e faunës së egër, ruajtja e ekosistemeve dhe kontrolli i aktiviteteve që mund të ndikojnë në gjendjen e tyre kontribuojnë në ruajtjen e cilësisë së mjedisit dhe të ekuilibrave ekologjikë.Përmirësimi i monitorimit dhe kontrollit të llojeve të egra mund të kontribuojë gjithashtu në parandalimin e rreziqeve që mund të lidhen me ndërveprimin e pakontrolluar me kafshët e egra dhe me përhapjen e llojeve invazive. Për këtë arsye, ndërhyrja pritet të ketë ndikim pozitiv afatgjatë mbi shëndetin publik, kryesisht përmes ruajtjes së ekosistemeve dhe përmirësimit të menaxhimit të faunës së egër.

Pjesëmarrja publike

Projektligji pritet të ndikojë pozitivisht në pjesëmarrjen publike, pasi forcimi i kuadrit për mbrojtjen e faunës së egër kërkon më shumë transparencë, informim dhe përfshirje të palëve të interesit. Organizatat e shoqërisë civile, institucionet akademike, komunitetet lokale dhe operatorët ekonomikë kanë interes të drejtpërdrejtë në proceset që lidhen me mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër. Pjesëmarrja publike është e rëndësishme jo vetëm gjatë konsultimit të projektligjit, por edhe në fazën e zbatimit, veçanërisht për hartimin e akteve nënligjore, përcaktimin e procedurave praktike, monitorimin e gjendjes së faunës së egër dhe evidentimin e problematikave në terren.

Ndikimet mjedisore

Ndikimet mjedisore të projektligjit pritet të jenë pozitive, veçanërisht në afatmesëm dhe afatgjatë. Situata bazë karakterizohet nga presione të vazhdueshme mbi faunën e egër, përfshirë humbjen dhe degradimin e habitateve, fragmentimin e ekosistemeve, shqetësimin dhe dëmtimin e llojeve, gjuetinë dhe shfrytëzimin e paligjshëm, introduktimin dhe përhapjen e llojeve jo-vendase dhe invazive, ndryshimet klimatike, ndotjen dhe zhvillimet infrastrukturore. Ndërhyrja synon të përmirësojë këtë situatë duke forcuar mekanizmat ligjorë për mbrojtjen, monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e faunës së egër.

Përfitimet mjedisore pritet të përfshijnë:

- përmirësimin e statusit të ruajtjes së llojeve të faunës së egër;
- forcimin e monitorimit të popullatave dhe habitateve;
- përmirësimin e mbrojtjes së habitateve;
- reduktimin e presioneve antropogjene;
- forcimin e masave për menaxhimin e llojeve jo-vendase dhe invazive;
- përmirësimin e kontrollit dhe zbatimit të masave të ruajtjes;
- forcimin e lidhshmërisë ekologjike;
- rritjen e përputhshmërisë me standardet e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

Treguesit që mund të përdoren për të matur ndikimin mjedisor përfshijnë numrin e llojeve të monitoruara, trendin e popullatave të llojeve të mbrojtura, numrin e rasteve të identifikuara dhe të menaxhuara të dëmtimeve ekologjike, numrin e rasteve të llojeve invazive të raportuara dhe masat e ndërmarra për kontrollin e tyre.

Kostoja e mosndërhyrjes

Mosndërhyrja do të ruante boshllëqet ekzistuese në kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e faunës së egër. Kjo do të sillte rrezik për vazhdimin e problemeve në monitorim dhe raportim, pasiguri në ndarjen e përgjegjësive institucionale, vështirësi në kontrollin e aktiviteteve që ndikojnë mbi llojet e egra dhe vonesa në përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian. Në aspektin mjedisor, mosndërhyrja mund të ndikojë negativisht në ruajtjen afatgjatë të llojeve dhe habitateve të tyre. Në aspektin ekonomik, mungesa e një kuadri të qartë mund të kufizojë zhvillimin e turizmit natyror dhe aktiviteteve të tjera të qëndrueshme që lidhen me

vlerat natyrore. Në aspektin institucional, mosndërhyrja do të ruante fragmentimin e të dhënave, monitorimit, raportimit dhe përgjegjësive ndërmjet institucioneve.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Ndikimet jo të drejtpërdrejta lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ruajtjen e kapitalit natyror, zhvillimin e turizmit natyror, përmirësimin e shërbimeve të ekosistemit dhe forcimin e reputacionit të vendit në fushën e mbrojtjes së natyrës. Përmirësimi i kuadrit ligjor për faunën e egër mund të nxisë kërkimin shkencor, monitorimin, inovacionin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, akademisë dhe sektorit privat. Në afatgjatë, këto ndikime mund të kontribuojnë në rritjen e vlerës ekonomike të biodiversitetit, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e aksesit në programe e financime të Bashkimit Evropian.

Ndikimi mbi konkurrencën

Projektligji nuk krijon barriera të drejtpërdrejta për hyrjen në treg dhe nuk vendos kufizime të pajustifikuara mbi aktivitetin ekonomik.Përkundrazi, ai synon të krijojë kushte më të qarta dhe më të barabarta për subjektet që ushtrojnë veprimtari të lidhura me faunën e egër, duke rritur transparencën dhe sigurinë juridike. Ndikimi mbi konkurrencën pritet të jetë pozitiv në afatgjatë, pasi subjektet që respektojnë kërkesat ligjore dhe standardet e qëndrueshmërisë do të operojnë në një mjedis më të rregulluar dhe më të parashikueshëm. Megjithatë, për të shmangur barrën e tepërt mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zbatimi duhet të mbështetet në procedura proporcionale, udhëzime të qarta dhe mbështetje institucionale.

Kufizimet e analizës

Analiza mbështetet në informacionin ekzistues mbi gjendjen e faunës së egër, kuadrin ligjor dhe institucional në uqi, si dhe kërkesat e përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian. Një kufizim i rëndësishëm lidhet me mungesën e të dhënave të plota sasiore s, të cilat identifikohen si më poshtë:

Numri i subjekteve te prekura: nuk disponohen të dhëna të plota të konsoliduara për numrin e operatorëve ekonomik, institucioneve kërkimore dhe subjekteve të tjera që ushtrojnë veprimtrari të lidhura me faunën e egër. Për rrjedhojë nuk është kryer një vlerësim sasor sipas kategorive të subjekteve.

Kostot administrative dhe të pajtueshmërisë: nuk disponohen të dhëna të detajuara për koston mesatare të dokumentacionit, autorizimeve, raortimit, kontrolleve dhe kohës administrative për secilën kategori operatorësh. Megjithatë, duke qenë se projektligji nuk parashikon detyrime të reja përtej kuadrit ligjor ekzistues, nuk janë identifikuar kosto shtesë të drejtpërdrejta që të kërkojnë përllogaritje të veçantë.

Kapacitetet insitiucionale: analiza nuk përfshin matje të vecanta sasiore të kohës së punës apo kostove për institucionet përgjegjëse, pasi projektligji nuk parashikon shtim të funksioneve dhe detyrave përtej kompetencave ekzistuese.

Vlera ekonomike e përfitimeve mjedisore dhe sociale: nuk disponohen të dhëna bazë dhe një metodologji e përshtatshme për të përcaktuar në terma monetarë vlerën e përfitimeve që lidhen me ruajtjen e llojeve, habitateve, shërbimeve të ekosistemit, shëndetin publik, mirëqenien sociale. Për këtë arsye, këto përfitime janë vlerësuar në mënyrën cilësore dhe nuk janë përfshirë si vlera monetare.

Përfundimet mbi kostot mbështeten në faktin se projektligji nuk parashikon detyrime të reja, ndërsa përfitimet mjedisore dhe sociale janë trajtuar në mënyrë cilësore.

Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

Opsioni 0 – status quo ruan situatën ekzistuese, por nuk adreson boshllëqet ligjore dhe institucionale në fushën e mbrojtjes së faunës së egër. Ky opsion ka kosto më të ulët administrative në afatshkurtër, por nuk garanton përmirësimin e sistemit të mbrojtjes, monitorimit dhe raportimit dhe nuk siguron përafrimin e nevojshëm me acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni 1 – amendimi i ligjit ekzistues krijon bazën më të përshtatshme për forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e faunës së egër, përmirësimin e monitorimit dhe raportimit, qartësimin e përgjegjësive institucionale dhe përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni 2 – miratimi i një ligji të ri mund të krijojë një kuadër më të plotë, por do të kërkonte një proces më të gjerë ristrukturimi institucional, kosto më të larta administrative dhe një periudhë më të gjatë zbatimi.

Opsioni 3 – qasja jo-rregullatore mund të sjellë disa përmirësime administrative, por nuk garanton bazën e nevojshme ligjore për adresimin e boshllëqeve ekzistuese dhe përmbushjen e kërkesave të acquis të Bashkimit Evropian.

Opsioni 1 rezulton opsioni i preferuar, pasi siguron raportin më të favorshëm ndërmjet efektivitetit, kostove të zbatimit, zbatueshmërisë institucionale dhe përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian. Kjo përputhet edhe me analizën e shumëkritereve të RIA-s së Faunës, ku Opsioni 1 rezulton alternativa më e balancuar.

Institucionet publike
Vlerësimi i ndikimit financiar dhe administrativ

Zbatimi i Opsionit 1 – amendimi i ligjit ekzistues nuk parashikon krijimin e institucioneve të reja dhe mbështetet në strukturat dhe kapacitetet ekzistuese institucionale. Kostot e zbatimit lidhen kryesisht me monitorimin e faunës së egër nga AKM, angazhimin e stafit të pushtetit vendor dhe stafin e zonave të mbrojtura (AdZM). Në përputhje me përllogaritjet e paraqitura në Shtojcën 2/A, këto kosto paraqiten në mijë lekë (000 lekë), si më poshtë. Për periudhat shumëvjeçare, vlerat përfaqësojnë koston për secilin vit.

Elementi	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Vitet 4–5, për vit	Vitet 6–10, për vit
Monitorimi i faunës së egër	1,000	1,100	500	500	1,500
Stafi i pushtetit vendor	146	146	146	146	146
Stafi i zonave të mbrojtura	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
Kosto në total	**2,546**	**2,646**	**2,046**	**2,046**	**3,046**

Kostot e paraqitura përfaqësojnë vlerën e burimeve njerëzore të parashikuara për monitorimin e faunës së egër, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, raportimin dhe administrimin e specieve dhe habitateve. Për përcaktimin e kostos ekonomike shtesë të projektligjit duhet të dallohet angazhimi shtesë nga veprimtaritë që institucionet kryejnë edhe në kushtet e legjislacionit ekzistues.

Burimet financiare të nevojshme për përmbushjen e funksioneve të parashikuara do të mbulohen brenda tavaneve buxhetore të miratuara dhe nëpërmjet përdorimit të kapaciteteve dhe strukturave ekzistuese institucionale.

Në kuadër të zbatimit të projektligjit, angazhimi i këtyre strukturave lidhet me planifikimin dhe kryerjen e vrojtimeve në terren, regjistrimin e të dhënave mbi speciet dhe habitatet, evidentimin

e presioneve dhe dëmtimeve, verifikimin dhe konsolidimin e informacionit, përgatitjen e raportimeve dhe ndjekjen e masave të menaxhimit. Këto veprimtari synojnë përmirësimin dhe standardizimin e ushtrimit të funksioneve ekzistuese.

Shpeshtësia e angazhimit të specialistëve për monitorimin e faunës varet nga lloji i aktivitetit, sipërfaqja që monitorohet, llojet e faunës dhe ndikimet e mundshme në habitat. Si vlerësim orientues, parashikohet një angazhim prej 1–2 ditësh monitorimi në terren nga specialistët e strukturave përgjegjëse. Përllogaritja është kryer duke marrë në konsideratë numrin e stafit të specializuar, ditët e angazhimit dhe pagën bruto sipas kategorisë së specialistëve, përfshirë shtesat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Për AdZM-të dhe pushtetin vendor është parashikuar një angazhim konstant prej 2 ditësh në muaj për punonjës gjatë gjithë periudhës së analizës. Për AKM-në, angazhimi prej 2 ditësh në muaj për punonjës përfaqëson bazën referuese të vitit të parë, ndërsa në vitet pasardhëse koha e angazhimit ndryshon në varësi të intensitetit të aktiviteteve të monitorimit dhe raportimit, sipas përllogaritjeve të paraqitura në analizën narrative dhe në Shtojcën 2/A.

Frekuenca e angazhimit përcakton kohën e punës së specialistëve, por jo numrin e monitorimeve, i cili varet nga përbërja e ekipeve, kohëzgjatja e monitorimit dhe nevojat territoriale e sezonale.

Më konkretisht përllogaritja eshte kryer si vijon:

Për specialistët e AdZM-ve, efekti financiar është përllogaritur mbi bazën e angazhimit të 12 punonjësve, me nga 2 ditë pune në muaj gjatë vitit buxhetor. Për specialistët e AKM-së, përllogaritja është mbështetur në angazhimin e 10 punonjësve, me një frekuencë referuese prej 2 ditësh pune në muaj gjatë vitit të parë, e cila ndryshon në vitet pasardhëse në varësi të intensitetit të aktiviteteve të monitorimit. Për pushtetin vendor, efekti financiar është përllogaritur mbi bazën e angazhimit të 2 punonjësve gjithsej, me nga 2 ditë pune në muaj gjatë vitit buxhetor.

Mbi këtë bazë, zbërthimi aritmetik i kostove është si vijon:

Për AdZM-të, angazhimi i 12 punonjësve për 2 ditë në muaj gjatë 12 muajve përfaqëson 288 ditë-person në vit. Shuma prej 1,400,000 lekësh në vit nënkupton një kosto mesatare prej 4,861.11 lekësh për ditë-person. Për rrjedhojë, përllogaritja rakordohet si: 12 punonjës × 2 ditë/muaj × 12 muaj × 4,861.11 lekë/ditë ≈ 1,400,000 lekë/vit.

Për AKM-në, përllogaritja e kostove është mbështetur në angazhimin e 10 punonjësve, me një frekuencë referuese prej 2 ditësh pune në muaj për secilin gjatë vitit të parë të zbatimit të projektligjit. Ky angazhim përfaqëson 240 ditë-person në vit. Shuma prej 1,000,000 lekësh për vitin e parë nënkupton një kosto mesatare prej 4,166.67 lekësh për ditë-person. Për rrjedhojë, përllogaritja rakordohet si: 10 punonjës × 2 ditë/muaj × 12 muaj × 4,166.67 lekë/ditë ≈ 1,000,000 lekë/vit.

Për vitet në vijim, është parashikuar një intensitet i diferencuar i aktiviteteve të monitorimit dhe raportimit, në varësi të fazave të zbatimit të projektligjit. Konkretisht, në vitin e dytë parashikohet rritja e angazhimit për konsolidimin e procesit të monitorimit dhe raportimit, me një kosto prej 1,100 mijë lekësh. Gjatë viteve 3–5, angazhimi parashikohet të jetë më i kufizuar,

duke u përqendruar në monitorimin periodik dhe administrimin e të dhënave, me një kosto prej 500 mijë lekësh në vit. Në vitet 6–10 parashikohet intensifikimi i aktiviteteve të monitorimit, përditësimit të të dhënave dhe vlerësimit të gjendjes së faunës së egër, me një kosto prej 1,500 mijë lekësh në vit.

Duke ruajtur të pandryshuar numrin prej 10 punonjësish dhe koston mesatare ditore prej 4,166.67 lekësh, vlerat e parashikuara korrespondojnë me një angazhim mesatar prej 2 ditësh në muaj për punonjës në vitin e parë, 2.2 ditësh në vitin e dytë, 1 ditë në muaj gjatë viteve 3–5 dhe 3 ditësh në muaj gjatë viteve 6–10. Për rrjedhojë, ndryshimet e kostove lidhen me ndryshimin e kohës së angazhimit të personelit dhe jo me rritjen e pagave apo shtimin e numrit të punonjësve.
Shpërndarja e kohës së angazhimit gjatë periudhës dhjetëvjeçare është vlerësuar në funksion të nevojave të parashikuara për monitorim dhe raportim në secilën fazë të zbatimit, duke ruajtur të pandryshuar numrin e specialistëve dhe koston ditore të personelit.

Kostot njëherëshe

Përveç kostove të vazhdueshme për monitorimin, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, janë parashikuar kosto njëherëshe prej 400 mijë lekësh në vitin e parë dhe 200 mijë lekësh në vitin e dytë të zbatimit të projektligjit.

Kostoja prej 400 mijë lekësh në vitin e parë lidhet me aktivitetet përgatitore për zbatimin e kuadrit të ri ligjor, përfshirë hartimin dhe përshtatjen e metodologjive të monitorimit të faunës së egër, përgatitjen e formateve të standardizuara për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, si dhe koordinimin teknik ndërmjet institucioneve përgjegjëse.

Kostoja prej 200 mijë lekësh në vitin e dytë lidhet me rishikimin dhe përmirësimin e instrumenteve të përgatitura gjatë vitit të parë, harmonizimin e procedurave të raportimit dhe mbështetjen teknike për zbatimin e tyre.

Këto kosto përfaqësojnë angazhime të kufizuara në kohë, të cilat nuk përsëriten në vitet pasardhëse dhe dallohen nga kostot e vazhdueshme të monitorimit në terren. Aktivitetet parashikohen të realizohen nëpërmjet angazhimit të personelit ekzistues të institucioneve përgjegjëse, përfshirë strukturat e vetëqeverisjes vendore, pa krijuar struktura të reja apo shtuar numrin e punonjësve.

Rakordimi me analizën financiare

Kostot në vazhdim të paraqitura në tabelë arrijnë në 26,660 mijë lekë për periudhën dhjetëvjeçare, përpara skontimit. Duke shtuar kostot e njëhershme të paraqitura në Shtojcën 2/A, prej 400 mijë lekësh në vitin e parë dhe 200 mijë lekësh në vitin e dytë, kostoja nominale totale është 27,260 mijë lekë. Me zbatimin e faktorëve zbritës të përdorur në këtë shtojcë, vlera aktuale e kostove rezulton rreth 21,857 mijë lekë, ose 21.857 milionë lekë.

Vlera prej 72.8 milionë lekësh e përmendur në koment nuk rakordohet me kostot e tabelës aktuale. Nëse nuk përfshin komponentë të tjerë të dokumentuar, ajo duhet të zëvendësohet me vlerën aktuale që rezulton nga Shtojca 2/A. Ky rakordim verifikon përputhjen aritmetike të shumave; justifikimi përfundimtar i tyre kërkon dokumentimin e kostove për njësi dhe të angazhimit shtesë.

Përfitimet kryesore lidhen me:

-ruajtjen e llojeve të faunës së egër;
-mbrojtjen dhe përmirësimin e habitateve;
-përmbushjen e acquis të Bashkimit Evropian;
-përmirësimin e monitorimit;
-përmirësimin e menaxhimit të zonave të mbrojtura;
-reduktimin e presioneve mbi llojet e kërcënuara;
-forcimin e kontrollit ndaj llojeve jo-vendase dhe invazive.

Këto përfitime janë afatgjata dhe kryesisht mjedisore, institucionale dhe sociale. Ato nuk janë monetizuar në këtë fazë, për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për një vlerësim të besueshëm të përfitimit shtesë që i atribuohet projektligjit.

Biznesi / sektori privat

- Qartësim i procedurave që lidhen me mbrojtjen dhe përdorimin e faunës së egër.
- Rritje e sigurisë juridike për aktivitetet ekonomike dhe kërkimore.
- Për disa subjekte, rritje e kërkesave për përputhshmëri, por pa vendosjen e një barre të re fiskale të përgjithshme.
- Përmirësim i parashikueshmërisë së kuadrit rregullator.

Shoqëria civile dhe institucionet kërkimore

- Rritje e aksesit në të dhëna dhe transparencë më e madhe.
- Mundësi më të mira për monitorimin e faunës së egër.
- Përmirësim i bashkëpunimit me institucionet publike.
- Mundësi më të mira për pjesëmarrje në proceset e politikave mjedisore.

Qytetarët dhe komunitetet lokale

- Përmirësim i ruajtjes së faunës së egër dhe habitateve.
- Përfitime afatgjata nga shërbimet e ekosistemit.
- Përmirësim i mundësive për zhvillimin e turizmit natyror.
- Përmirësim i cilësisë së mjedisit.

Ndikimi mbi këto komunitete është kryesisht **indirekt**, përmes përmirësimit të monitorimit dhe administrimit të faunës së egër dhe ruajtjes së habitateve që mbështesin aktivitetet e tyre. Për bujqësinë dhe blegtorinë, ndikimi lidhet me ruajtjen e funksioneve të ekosistemit; për përdoruesit e burimeve pyjore dhe kullosore, me ruajtjen afatgjatë të gjendjes së habitateve; ndërsa për shërbimet turistike lokale, me ruajtjen e vlerave natyrore mbi të cilat mbështetet veprimtaria e tyre.
Projektligji nuk parashikon ndryshime të drejtpërdrejta në të drejtat e përdorimit të tokës, pyjeve dhe kullotave, në regjimin e gjuetisë apo në kushtet e ushtrimit të veprimtarive ekonomike në zonat e mbrojtura, përtej kuadrit ligjor ekzistues. Për këto aktivitete të komuniteteve lokale nuk parashikohen kufizime ose detyrime të reja të përgjithshme; detyrimet ekzistuese për mbrojtjen e faunës së egër dhe habitateve vijojnë të zbatohen.

Analiza e ndikimeve sipas sektorëve të prekur
Ndërhyrja e propozuar nuk synon vendosjen e kostove të reja të drejtpërdrejta për sektorët ekonomikë, bizneset apo përdoruesit e burimeve natyrore.

Ndikimet pritet të jenë kryesisht cilësore dhe të lidhura me rritjen e qartësisë ligjore, përmirësimin e menaxhimit të faunës së egër, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe forcimin e sigurisë juridike për subjektet që veprojnë në sektorë të lidhur me natyrën.

Turizmi

Projektligji mund të kontribuojë në mënyrë indirekte në mbështetjen e turizmit natyror dhe ekoturizmit, nëpërmjet forcimit të monitorimit dhe ruajtjes së faunës së egër dhe habitateve natyrore. Evidentimi i presioneve dhe përdorimi i të dhënave për përcaktimin e masave të menaxhimit mund të ndihmojnë në parandalimin e degradimit të zonave që përdoren për vrojtimin e shpendëve, vizitat në natyrë dhe veprimtari të tjera turistike.

Të dhënat zyrtare tregojnë rëndësinë e këtyre zonave për turizmin. Sipas publikimit të Ministrisë së Mjedisit të datës 15 janar 2026, gjatë vitit 2025 zonat e mbrojtura të Shqipërisë janë vizituar nga rreth 5.9 milionë vizitorë, që përfaqëson një rritje prej rreth 6% krahasuar me vitin 2024. Ky fluks tregon rëndësinë e ruajtjes së vlerave natyrore mbi të cilat mbështeten veprimtaritë turistike dhe shërbimet e komuniteteve lokale.

Këto të dhëna përshkruajnë situatën bazë dhe tendencën e turizmit në zonat e mbrojtura. Rritja e regjistruar nuk përbën efekt të projektligjit. Kontributi i pritshëm i ndërhyrjes lidhet me ruajtjen e habitateve dhe specieve që mbështesin turizmin natyror, përmes monitorimit më të mirë dhe marrjes së masave për reduktimin e presioneve mbi to.

Për vitin 2025, analiza nuk disponon një vlerë të verifikuar të të ardhurave nga vizitorët në zonat e mbrojtura ose të shpenzimit mesatar të tyre. Gjithashtu, mungojnë të dhënat që mundësojnë veçimin e efektit të ndryshimeve ligjore nga faktorët e tjerë që ndikojnë në flukset turistike. Për këtë arsye, përfitimi i mundshëm nga projektligji trajtohet në mënyrë cilësore dhe nuk përfshihet si vlerë monetare në analizën financiare.

Ndikimi i pritshëm i projektligjit është kryesisht indirekt dhe lidhet me ruajtjen e burimeve natyrore mbi të cilat mbështeten veprimtaritë turistike dhe shërbimet e komuniteteve lokale. Projektligji nuk parashikon detyrime të reja apo kosto shtesë të drejtpërdrejta për operatorët vetëm për shkak të ushtrimit të veprimtarisë turistike. Respektimi i kërkesave mjedisore vijon të rregullohet nga legjislacioni në fuqi.

Bujqësia
Bujqësia ndikohet nga gjendja e faunës së egër dhe biodiversitetit përmes shërbimeve të ekosistemit, kontrollit natyror të dëmtuesve, pjalmimit dhe ruajtjes së ekuilibrave ekologjikë. Mbrojtja më efektive e faunës së egër kontribuon në qëndrueshmërinë afatgjatë të prodhimit bujqësor. Ndërhyrja nuk vendos kosto të reja të përgjithshme për fermerët, por nxit përdorimin më të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Pyjet
Pyjet janë një nga habitatet më të rëndësishme për faunën e egër. Ndikimi mbi sektorin e pyjeve pritet të jetë pozitiv, pasi përmirësimi i monitorimit dhe mbrojtjes së faunës së egër mbështet menaxhimin më të qëndrueshëm të fondit pyjor.Nuk parashikohen kosto shtesë të drejtpërdrejta, por kërkohet zbatim më i koordinuar i detyrimeve ekzistuese për mbrojtjen e habitateve pyjore.

Peshkimi
Peshkimi dhe akuakultura janë veprimtari që lidhen drejtpërdrejt me gjendjen e ekosistemeve ujore, lagunave, lumenjve, liqeneve dhe zonave bregdetare. Ndikimi i projektligjit mbi këta sektorë vlerësohet si indirekt, pasi dispozitat e tij nuk rregullojnë drejtpërdrejt ushtrimin e veprimtarive të peshkimit dhe akuakulturës, nuk ndryshojnë kushtet e licencimit apo autorizimit dhe nuk vendosin detyrime të reja për raportim, kontroll apo kosto administrative për subjektet e këtyre sektorëve, përtej kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ndikimi indirekt lidhet me përmirësimin e mbrojtjes së faunës së egër dhe habitateve ujore, i cili mund të

kontribuojë në ruajtjen e popullatave të llojeve vendase dhe në qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve natyrore nga të cilat varen këto veprimtari.

Aktivitetet kërkimore
Institucionet akademike, kërkimore dhe ekspertët e faunës së egër ndikohen kryesisht përmes përmirësimit të aksesit në të dhëna, standardizimit të metodologjive të monitorimit dhe qartësimit të procedurave për aktivitetet kërkimore. Kjo pritet të rrisë cilësinë e kërkimit shkencor dhe përdorimin e rezultateve të tij në vendimmarrje.

Investimet private
Investimet private që lidhen me turizmin, menaxhimin e burimeve natyrore, kërkimin shkencor apo sektorë të tjerë me ndikim në faunën e egër përfitojnë nga një kuadër më i qartë dhe më i parashikueshëm. Qartësimi i rregullave ndihmon në uljen e pasigurisë juridike dhe orientimin e investimeve drejt modeleve më të qëndrueshme.

Pronësia dhe përdorimi i tokës
Ndërhyrja nuk cenon të drejtën e pronësisë dhe nuk parashikon ndryshime në regjimin e pronësisë mbi tokën. Ndikimi lidhet kryesisht me mënyrën e përdorimit të tokës në rastet kur ajo ndodhet në zona me vlera të larta natyrore ose pranë habitateve të rëndësishme për faunën e egër.

Në këto raste, përdorimi i tokës duhet të jetë në përputhje me legjislacionin ekzistues mjedisor, planifikimin territorial dhe kërkesat për mbrojtjen e natyrës. Për rrjedhojë, ndikimi mbi pronësinë vlerësohet neutral, ndërsa ndikimi mbi përdorimin e tokës lidhet me orientimin drejt përdorimit të qëndrueshëm dhe shmangien e dëmtimit të habitateve dhe llojeve.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME)
Ndërhyrja nuk parashikon vendosjen e detyrimeve të reja financiare të përgjithshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndikimi i drejtpërdrejtë mbi SME-të vlerësohet i kufizuar dhe kryesisht administrativ. SME-të që mund të preken në mënyrë të tërthortë janë kryesisht ato që ushtrojnë veprimtari në sektorë të lidhur me turizmin natyror, aktivitetet kërkimore, menaxhimin e burimeve natyrore, aktivitetet zoologjike ose përdorimin e kafshëve të egra. Numri i saktë i SME-ve të prekura nuk mund të përcaktohet në këtë fazë. Sa i përket kostove të përshtatjes, raportimit dhe administrimit, këto nuk monetizohen për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për një përllogaritje të besueshme.Në përfundim, ndikimi kryesor mbi këtë kategori është indirekt dhe lidhet me përmirësimin e qartësisë ligjore, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe krijimin e kushteve më të qëndrueshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike që varen nga biodiversiteti dhe fauna e egër.

Ndikimet cilësore jo të drejtpërdrejta
Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm
- Ruajtje afatgjatë e kapitalit natyror.
- Mbështetje për turizmin natyror dhe ekonominë e gjelbër.
- Ulje e kostove të ardhshme të restaurimit të habitateve.
- Përmirësim i qëndrueshmërisë së sektorëve që varen nga natyra.

Mjedisi
- Përmirësim i statusit të ruajtjes së llojeve të faunës së egër.
- Mbrojtje dhe restaurim i habitateve.
- Reduktim i presioneve antropogjene.
- Reduktim i rrezikut nga llojet invazive.
- Forcim i lidhshmërisë ekologjike.

Shoqëria

- Rritje e ndërgjegjësimit publik për faunën e egër.
- Përmirësim i cilësisë së jetës në komunitetet lokale.
- Rritje e mundësive për zhvillimin e turizmit natyror.
- Përmirësim i përfshirjes së komuniteteve në mbrojtjen e natyrës.

Ndikimi mbi konkurrencën

- Ndërhyrja nuk krijon barriera të reja të drejtpërdrejta në treg.
- Rritja e kërkesave të përputhshmërisë mund të ndikojë në mënyrë të moderuar subjektet që zhvillojnë aktivitete të lidhura me faunën e egër.
- Në afatgjatë:
  - përmirëson konkurrueshmërinë e sektorëve që operojnë në mënyrë të qëndrueshme;
  - rrit sigurinë juridike;
  - krijon kushte më të mira për akses në tregje dhe fonde ndërkombëtare për subjektet që respektojnë standardet e BE-së.

Krahasimi i opsioneve

Opsioni 0 – Status quo: Nuk adreson problemet ekzistuese; ruan boshllëqet ligjore dhe institucionale dhe nuk siguron përafrimin e nevojshëm me acquis të BE-së.
Opsioni 1 – Amendimi i ligjit ekzistues: Përmirësim i ndjeshëm i kuadrit ligjor; ndikim pozitiv; përdor strukturat ekzistuese dhe siguron përafrim më efektiv me acquis të BE-së.
Opsioni 2 – Ligj i ri: Mund të sigurojë një kuadër më të plotë, por shoqërohet me kosto më të larta institucionale, ristrukturim më të gjerë dhe periudhë më të gjatë zbatimi.
Opsioni 3 – Jo-rregullator: Ndikim pozitiv i kufizuar; nuk zgjidh boshllëqet strukturore dhe nuk garanton bazën e nevojshme ligjore për përmbushjen e kërkesave të BE-së.

Opsioni 1 është opsioni i preferuar. Analiza e Faunës e mbështet këtë përzgjedhje, duke e vlerësuar Opsionin 1 si alternativën më të balancuar ndërmjet efektivitetit, kostove, zbatueshmërisë institucionale dhe përafrimit me acquis të BE-së.

~~**Analiza sasiore dhe monetare e ndikimeve të drejtpërdrejta.**~~

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e opsioneve të shqyrtuara dhe vlerësimin e ndikimeve, si opsion i preferuar është përzgjedhur **Opsioni 1 – kryerja e disa ndryshimeve në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër"**. Opsioni 1 është vlerësuar si alternativa më e përshtatshme, efektive dhe proporcionale, pasi siguron balancën më të mirë midis nevojës për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e faunës së egër, kapaciteteve institucionale ekzistuese dhe detyrimeve të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian.

Një ndërhyrje ligjore është e përshtatshme sepse:

- boshllëqet kryesore të identifikuara kërkojnë ndërhyrje në dispozitat ekzistuese të ligjit dhe nuk mund të adresohen plotësisht vetëm përmes praktikave administrative;
- kërkohet përafrim i drejtpërdrejtë me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me Direktivën 2009/147/KE për mbrojtjen e shpendëve të egër dhe Direktivën 1999/22/KE për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshte zoologjike;
- nevojitet forcimi i bazës ligjore për monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e faunës së egër dhe shpendëve të egër;
- kërkohet përmirësimi i kuadrit për menaxhimin e llojeve jo-vendase dhe rregullimin e kopshteve zoologjike;

· kërkohet qartësimi dhe përmirësimi i përgjegjësive dhe mekanizmave institucionalë për zbatimin e legjislacionit për faunën e egër.

Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit ekzistues (**Opsioni 1**) vlerësohet si instrumenti më i përshtatshëm, proporcional dhe efektiv për adresimin e problematikave të identifikuara.

Arsyet kryesore janë:

1. Përafrimi me acquis të BE-së- Ky opsion mundëson harmonizimin e drejtpërdrejtë të legjislacionit kombëtar me:

- Direktivën 2009/147/KE për mbrojtjen e shpendëve të egër;
- Direktivën 1999/22/KE për mbajtjen e kafshëve të egra në kopshte zoologjike.

Përafrimi me këto akte është i rëndësishëm për forcimin e kuadrit kombëtar për mbrojtjen e faunës së egër dhe për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe Kapitullit 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike.

2. Zgjidh problemet kryesore të identifikuara- Opsioni 1 adreson boshllëqet ekzistuese në

- monitorimin dhe raportimin e shpendëve të egër;
- funksionimin dhe menaxhimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët;
- mbrojtjen dhe menaxhimin e faunës së egër;
- menaxhimin e llojeve jo-vendase;
- rregullimin dhe funksionimin e kopshteve zoologjike;
- forcimin e mekanizmave të monitorimit, kontrollit dhe raportimit;
- qartësimin e përgjegjësive institucionale.

Ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin e dispozitave ekzistuese pa ndryshuar në mënyrë thelbësore strukturën e ligjit. Në këtë kuadër, ndërhyrjet e propozuara nuk tejkalojnë 50% të përmbajtjes së ligjit ekzistues, duke e bërë amendimin e tij një alternativë proporcionale me problematikat e identifikuara.

3. Efikasitet dhe proporcionalitet

- Nuk kërkon krijimin e strukturave të reja institucionale;
- Përdor kapacitetet ekzistuese shtetërore;
- Mundëson zbatimin gradual të ndryshimeve;
- Ka kosto të kufizuara administrative dhe financiare;
- Ofron përfitime të rëndësishme afatgjata për mbrojtjen e faunës së egër;
- Shmang ristrukturimin e plotë të kuadrit ligjor ekzistues.

4. Zbatim më i shpejtë dhe më realist

Ndryshe nga hartimi i një ligji të ri të plotë për faunën e egër, që përbën **Opsionin 2**, amendimi i ligjit ekzistues kërkon një ndërhyrje më të kufizuar dhe mund të realizohet brenda një periudhe më të shkurtër.

Hartimi i një ligji të ri do të kërkonte ristrukturim më të gjerë të kuadrit ligjor ekzistues, harmonizim të dispozitave të reja, konsultim më të gjerë institucional dhe një periudhë më të gjatë për hartim, konsultim dhe miratim. Gjithashtu, mund të sillte kosto më të larta administrative dhe institucionale dhe të krijonte pasiguri gjatë periudhës së tranzicionit.

Opsioni i preferuar është Opsioni 1, i cili:

- mund të zbatohet më shpejt;
- shmang vonesat e procesit legjislativ për hartimin e një ligji tërësisht të ri;
- minimizon rrezikun e krijimit të boshllëqeve ligjore gjatë periudhës së tranzicionit;
- lejon përmirësimin gradual të kuadrit ekzistues.

5. Ndikim pozitiv i balancuar- Opsioni i përzgjedhur siguron:

- përmirësim të mbrojtjes së faunës së egër dhe shpendëve të egër;
- forcim të mekanizmave të monitorimit dhe raportimit;
- përmirësim të menaxhimit të llojeve jo-vendase;
- përmirësim të kuadrit për funksionimin e kopshteve zoologjike;
- forcim të kapaciteteve institucionale;
- rritje të transparencës dhe efektivitetit të zbatimit;
- mbështetje për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Përpara përzgjedhjes së opsionit të preferuar, është kryer një **analizë me shumë kritere** për të krahasuar opsionet e shqyrtuara në mënyrë sa më objektive dhe të strukturuar. Analiza vlerëson shkallën në të cilën secili opsion adreson problemin, përmbush objektivat e politikës, siguron përafrim me acquis të BE-së, është i zbatueshëm nga institucionet ekzistuese dhe nuk krijon barrë të panevojshme financiare apo administrative.

Kriteret e përdorura dhe pesha përkatëse janë: efektiviteti i mekanizmave në përmirësimin dhe mbrojtjen e faunës së egër dhe shpendëve të egër – **5**; përafrimi me acquis të BE-së – **4**; forcimi i monitorimit, raportimit dhe menaxhimit të të dhënave – **3**; efektiviteti në menaxhimin e llojeve jo-vendase dhe kopshteve zoologjike – **2**; lehtësia e zbatimit dhe përdorimi i kapaciteteve ekzistuese institucionale – **2**; dhe kosto-efektiviteti – **4**.

Kjo analizë shërben për të evidentuar opsionin që ofron balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit, proporcionalitetit, zbatueshmërisë dhe ndikimeve të pritshme.

Opsioni 0 – Mosveprimi / ruajtja e kuadrit ekzistues.
Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit ekzistues për mbrojtjen e faunës së egër, si opsion i preferuar.
Opsioni 2 – Miratimi i një ligji të ri për faunën e egër.
Opsioni 3 – Opsion jo-rregullator.

Kriteret e vlerësimit	Pesha	Opsioni 0 – Status quo	Opsioni 1 – Ndryshim i ligjit ekzistues	Opsioni 2 – Ligj i ri	Opsioni 3 – Opsion jo-rregullator
Përmirësimi i mbrojtjes së faunës së egër dhe shpendëve të egër	5	1 (5)	5 (25)	5 (25)	2 (10)
Përafrimi me acquis të BE-së (Direktiva 2009/147/KE dhe 1999/22/KE)	4	0 (0)	4 (16)	4 (16)	0 (0)
Forcimi i monitorimit, raportimit dhe menaxhimit të të dhënave	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)	2 (6)
Efektiviteti në menaxhimin e llojeve jo-vendase dhe kopshteve zoologjike	2	1 (2)	2 (4)	2 (4)	1 (2)
Lehtësia e zbatimit dhe përdorimi i kapaciteteve ekzistuese institucionale	2	0 (0)	2 (4)	2 (4)	1 (2)

Kriteret e vlerësimit	Pesha	Opsioni 0 – Status quo	Opsioni 1 – Ndryshim i ligjit ekzistues	Opsioni 2 – Ligj i ri	Opsioni 3 – Opsion jo-rregullator
Kosto-efektiviteti	4	1 (4)	4 (16)	3 (12)	2 (8)
Totali		**18**	**74**	**70**	**28**

Përfundim
Opsioni 1 përfaqëson zgjidhjen më të mirë në aspektin e efektivitetit, kostos, shpejtësisë së zbatimit dhe përputhshmërisë me standardet e BE-së. Ai adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë problemet e identifikuara në kuadrin ligjor për mbrojtjen e faunës së egër, pa krijuar barrë të panevojshme institucionale apo financiare, duke siguruar një reformë të qëndrueshme, proporcionale dhe të zbatueshme në praktikë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria përgjegjëse për mjedisin është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin, koordinimin dhe monitorimin e opsionit të zgjedhur, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), strukturat e inspektimit mjedisor dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i ndryshimeve të propozuara do të realizohet në mënyrë graduale, në përputhje me hyrjen në fuqi të dispozitave të projektligjit dhe afatet e parashikuara për miratimin e akteve nënligjore përkatëse. Ministria përgjegjëse për mjedisin do të koordinojë procesin e hartimit dhe miratimit të këtyre akteve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, duke siguruar zbatimin e njëtrajtshëm të kuadrit të ri ligjor.
Zbatimi mbështetet në ndarjen e qartë të përgjegjësive institucionale në fushën e menaxhimit të faunës së egër, monitorimit dhe kontrollit të aktiviteteve që ndikojnë në faunën e egër.

Gjatë zbatimit mund të shfaqen pengesa që lidhen kryesisht me:

- mungesën e kapaciteteve të plota teknike dhe njerëzore për monitorimin sistematik të faunës së egër dhe zbatimin e kërkesave të raportimit;
- fragmentimin aktual të të dhënave dhe mungesën e një sistemi të integruar kombëtar të informacionit për faunën e egër;
- nevojën për harmonizim të praktikave të inspektimit dhe monitorimit midis nivelit qendror dhe vendor;
- nevojën për rritje të koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e standardeve të reja të përafruara me acquis të BE-së.

Për arritjen e objektivave të politikës do të ndërmerren masa konkrete si më poshtë:

- hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit për zonat me rëndësi për shpendët e egër dhe faunën e egër;
- krijimi, shpallja dhe administrimi i Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA), përmes procedurave të standardizuara;

- zhvillimi dhe operimi i sistemit kombëtar të monitorimit, në zbatim të dispozitave të projektligjit që rregullojnë monitorimin dhe raportimin e gjendjes së faunës së egër
- kontrolli i introduktimit, ripopullimit dhe menaxhimit të llojeve jo-vendase dhe invazive;
- forcimi i regjimit të autorizimit, funksionimit dhe inspektimit të kopshteve zoologjike;
- zhvillimi i sistemit të raportimit dhe shkëmbimit të të dhënave ndërinstitucionale në përputhje me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian.

Zbatimi i ligjit mund të kërkojë miratimin ose përditësimin, sipas rastit, të akteve nënligjore që rrjedhin nga dispozitat e tij, përfshirë vendime të Këshillit të Ministrave dhe urdhra të ministrit përgjegjës për mjedisin, në funksion të:

- shpalljes, administrimit dhe menaxhimit të Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA);
- monitorimit dhe raportimit të gjendjes së faunës së egër;
- kontrollit të introduktimit, ripopullimit dhe menaxhimit të llojeve jo-vendase dhe invazive;
- autorizimit, funksionimit dhe inspektimit të kopshteve zoologjike;
- organizimit të sistemit të të dhënave dhe raportimit mjedisor, sipas kompetencave të përcaktuara në projektligj.

Përveç miratimit dhe përditësimit të akteve nënligjore, zbatimi efektiv i ligjit mbështetet edhe në masa institucionale dhe administrative që sigurojnë funksionimin e plotë të kuadrit ligjor.

Në zbatim të ndryshimeve të ligjit, do të hartohen ose përditësohen aktet nënligjore si më poshtë:

- urdhri i ministrit për kriteret dhe rregullat për dhënien e përjashtimeve nga ndalimet për mbrojtjen e shpendëve, duke përcaktuar llojet, metodat, kushtet dhe mekanizmat e kontrollit;
- urdhri i ministrit për rregullat e autorizimit të tregtimit të llojeve të shpendëve në përputhje me kërkesat e Direktivës së Shpendëve;
- urdhri i ministrit për përditësimin periodik të listës së llojeve të Aneksit I të Direktivës së Shpendëve, mbi bazën e të dhënave shkencore dhe rezultateve të monitorimit;
- urdhri i ministrit për formatin dhe përmbajtjen e informacionit që i transmetohet Komisionit Evropian për Zonat Veçanërisht të Mbrojtura;
- urdhri i ministrit për organizimin dhe funksionimin e qendrave të shpëtimit të faunës së egër;
- rregullat dhe procedurat për autorizimin e kopshteve zoologjike;
- rregullorja e ministrit për kushtet e posaçme të autorizimit, dokumentacionin, procedurat e shqyrtimit, pezullimit dhe shfuqizimit të autorizimit, si dhe rregullat për funksionimin, monitorimin dhe inspektimin e kopshteve zoologjike;
- aktet e tjera nënligjore të parashikuara në nenin 48 të ligjit, të nevojshme për zbatimin e dispozitave të ndryshuara.

Gjithashtu, zbatimi efektiv i ligjit kërkon:

- krijimin e një sistemi të integruar për mbledhjen, administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave mbi faunën e egër, në mbështetje të monitorimit dhe raportimit sipas kërkesave të legjislacionit;
- forcimin e kapaciteteve institucionale përmes trajnimeve të specializuara dhe pajisjeve teknike për monitorim;
- vendosjen e mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional për zbatimin e njëtrajtshëm të ligjit;

- standardizimin e metodologjive të monitorimit dhe raportimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian;
- monitorimin dhe raportimin periodik mbi ecurinë e zbatimit të ligjit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Projektligji përcakton një kuadër të qartë institucional për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e zbatimit të dispozitave për mbrojtjen e faunës së egër, me qëllim sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi, forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe garantimin e të dhënave të standardizuara e të krahasueshme në nivel kombëtar.

Monitorimi i zbatimit të ligjit bazohet në një sistem të integruar institucional, ku përgjegjësitë ndahen si më poshtë:

- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)** është përgjegjëse për mbledhjen, konsolidimin dhe përpunimin e të dhënave mbi gjendjen e faunës së egër, treguesit biologjikë dhe informacionin teknik të siguruar nga institucionet përgjegjëse;
- **Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)**, nëpërmjet administratave rajonale të zonave të mbrojtura, kryen monitorimin në terren të specieve dhe habitateve, përfshirë Zonat Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA), si dhe përgatit raportime teknike mbi gjendjen e tyre dhe zbatimin e masave të menaxhimit dhe ruajtjes;
- **Njësitë e vetëqeverisjes vendore** kontribuojnë në monitorimin lokal dhe raportimin e aktiviteteve që mund të ndikojnë në faunën e egër, sipas mekanizmave të përcaktuar për shkëmbimin e informacionit me strukturat përgjegjëse mjedisore;
- **Ministria përgjegjëse për mjedisin** siguron koordinimin e përgjithshëm të sistemit të monitorimit dhe raportimit, analizon informacionin e paraqitur nga institucionet përgjegjëse, vlerëson progresin në zbatimin e ligjit dhe përgatit raportimet kombëtare, përfshirë ato që lidhen me detyrimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Raportimi periodik mbi zbatimin e ligjit do të realizohet nëpërmjet këtij mekanizmi të koordinuar institucional, ku secili institucion do të raportojë në përputhje me kompetencat e tij ligjore dhe funksionale. Të dhënat e mbledhura do të konsolidohen në raporte teknike periodike, të cilat do të përdoren për vlerësimin e efektivitetit të masave të parashikuara në ligj, identifikimin e problematikave në zbatim dhe përcaktimin e masave korrigjuese.

Monitorimi do të realizohet nëpërmjet:

- funksionimit të sistemit të integruar të të dhënave për faunën e egër;
- programeve periodike të biomonitorimit dhe vëzhgimit në terren;
- inspektimeve dhe kontrolleve për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore;
- raportimeve teknike periodike nga institucionet përgjegjëse.

Sistemi i monitorimit do të mundësojë mbledhjen, administrimin dhe analizimin e informacionit mbi:

- statusin e ruajtjes së specieve të faunës së egër;
- tendencat e popullatave të shpendëve të egër;

- gjendjen e habitateve;
- administrimin e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA);
- ndikimet nga faktorët antropogjenë dhe masat e ndërmarra për reduktimin e tyre.

Progresi në zbatimin e objektivave të politikës matet nëpërmjet treguesve kryesorë, si:

- Rritja e përqindjes së llojeve prioritare të faunës së egër për të cilat disponohen të dhëna të përditësuara mbi statusin e ruajtjes.
- Përqindja e institucioneve përgjegjëse që raportojnë në sistemin kombëtar të monitorimit dhe raportimit brenda afateve të përcaktuara.
- Sipërfaqja (ha) e zonave të monitoruara, përfshirë Zonat Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA).
- Përqindja e zonave të mbrojtura që disponojnë dhe zbatojnë plane menaxhimi të miratuara.
- Trendi i popullatave të llojeve prioritare të monitoruara (stabilizim ose përmirësim i statusit të tyre).
- Përqindja e raporteve të monitorimit dhe raportimit të dorëzuara brenda afateve ligjore.
- Niveli i përputhshmërisë së sistemit të monitorimit dhe raportimit me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian.
- Përqindja e programeve të biomonitorimit të realizuara sipas planifikimit vjetor.
- Përqindja e Zonave Veçanërisht të Mbrojtura për Shpendët (SPA) të integruara në sistemin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe në instrumentet përkatëse të planifikimit dhe menaxhimit.

Raportimi do të realizohet në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e raportimit ndaj Bashkimit Evropian. AKM dhe AKZM do të sigurojnë të dhënat dhe raportet teknike, ndërsa Ministria përgjegjëse për mjedisin do të koordinojë procesin e vlerësimit, përgatitjen e raporteve kombëtare dhe ndjekjen e progresit në zbatimin e kuadrit ligjor.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë.

	Viti 1	**Viti 2**	**Viti 3**	**Viti 4**	**Viti 5**	**Viti 6**	**Viti 7**	**Viti 8**	**Viti 9**	**Viti 10**
Faktori zbritës	1.000 00	0.9528 35	0.9078 94	0.86507 3	0.82427 1	0.7853 94	0.748351	0.713055	0.679 423	0.647 378
Kosto për buxhetin e NJVV – njëhere *((kosto per stafin per projektligjin-paga))*	400	200	-	-	-	-	-	-	-	-

Kosto për buxhetin – në vazhdim *(kosto per monitorimin e faunes se eger nga AKM;* *kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki)* *kosto per stafin e zonave te mbrojtura AdZM-paga)*	2,546	2,646	2,046	2,046	2,046	3,046	3,046	3,046	3,046	3,046
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	**2,946**	**2,846**	**2,046**	**2,046**	**2,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	2,946	2,712	1,858	1,770	1,686	2,392	2,279	2,172	2,070	1,972
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim (persona fizikë, OJF, subjekte private ose komunitete lokale që do të marrin financim)										
Përfitimi në total										

Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Vlera aktuale e kostos në total	**21,857**									
Vlera aktuale e përfitimit në total	**-**									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	**(21,857)**									

Perllogaritja e kostove ne shtojcen 2/A lidhur me kostot e buxhetit ne vazhdim te analizuara paraqiten si ne tabele:
Shifrat në tabelë janë të shprehura në mijë (000) Lekë

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Kosto per monitorimin e faunes se eger nga AKM;	1,000	1,100	500	500	500	1500	1500	1500	1500	1500
Kosto për stafin e pushtetit vendor (bashki)	146	146	146	146	146	146	146	146	146	146
Kosto per stafin e zonave te mbrojtura AdZM-paga)	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400	1,400
Totali	**2,546**	**2,646**	**2,046**	**2,046**	**2,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**	**3,046**

Kostot e paraqitura në tabelë përfaqësojnë kostot ekonomike të lidhura me zbatimin e projektligjit për mbrojtjen e faunës së egër dhe lidhen kryesisht me monitorimin e faunës së egër, angazhimin e strukturave të pushtetit vendor dhe administrimin e zonave të mbrojtura nga strukturat përgjegjëse.

Kostot përfshijnë:

- kostot e monitorimit të faunës së egër nga AKM;
- kostot e stafit të njësive të vetëqeverisjes vendore të angazhuara në zbatimin e përgjegjësive që lidhen me faunën e egër;
- kostot e stafit të Administratave të Zonave të Mbrojtura (AdZM), të lidhura me administrimin dhe menaxhimin e faunës së egër në zonat e mbrojtura.

Si propozim orientues me ndikim mesatar në mjedis parashikohet 1-2 dite monitorim ne terren nga specialiste te strukturave përgjegjëse. Perllogaritja është kryer sipas një metodologjie ku është llogaritur numri i stafit të specializuar për të kryer monitorime, frekuenca e kontrollit bazuar në ditët e punës (2 ditë në muaj në terren për çdo vit buxhetor), paga bruto e përllogaritur mbi bazën e kategorisë së specialistëve të angazhuar dhe elementeve të tjera të shtesës për vjetërsi sipas legjislacionit në fuqi. Për specialistet e ADZM efekti financiar per monitorim per 2 dite ne muaj ne terren, në total për vitin buxhetor per 12 punonjes. Për specialistet e AKM efekti financiar për monitorim për 2 dite në muaj në terren, në total për vitin buxhetor 10 punonjës. Për Bashki efekti financiar për monitorim për 2 ditë në muaj në terren, në total për vitin buxhetor për 2 punonjës.

Këto kosto përfaqësojnë burimet që do të angazhohen për zbatimin dhe forcimin e funksioneve të monitorimit, raportimit dhe administrimit të faunës së egër. Ato do të përballohen brenda fondeve të miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), nëpërmjet strukturave dhe kapaciteteve institucionale ekzistuese, dhe **nuk paraqesin nevojë për alokim të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit**.

Kostoja ekonomike e zbatimit të projektligjit përfaqëson vlerën e burimeve njerëzore që do angazhohen për realizimin e detyrave të parashikuara nga projektligji, burime të cilat do të sigurohen nga strukturat ekzistuese të institucioneve përgjegjëse dhe do të përballohen nga fondet e miratuara në Programin Buxhetor Afatmesëm. Pra, angazhimi i stafit ekzistues ka kosto të përballueshme brenda institucioneve përgjegjëse dhe nuk kërkon fonde shtësë në buxhet. Në këtë kuptim, shpenzimi shtesë buxhetor është 0.

Përfitimet e projektligjit

Përfitimet kryesore të ndryshimeve të propozuara në kuadrin ligjor për faunën e egër lidhen me:

- përmirësimin e mbrojtjes dhe ruajtjes së faunës së egër;
- forcimin e monitorimit dhe raportimit për llojet e faunës së egër;
- përmirësimin e menaxhimit të shpendëve të egër dhe të zonave veçanërisht të mbrojtura për shpendët;
- përmirësimin e menaxhimit dhe kontrollit të llojeve jo-vendase dhe invazive, sipas fushës së ndërhyrjes;
- përmirësimin e administrimit dhe kontrollit të kopshteve zoologjike;
- forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e legjislacionit për faunën e egër;
- përafrimin me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat që lidhen me mbrojtjen e shpendëve të egër dhe faunës.

Këto përfitime janë afatgjata dhe kryesisht jo të monetizueshme. Për këtë arsye, ato nuk janë përfshirë si vlera monetare në llogaritjen e VAN-it, por janë marrë në konsideratë në mënyrë cilësore në vlerësimin e ndikimit dhe në krahasimin e opsioneve.

Stafi ekzistues kryen hartimin dhe zbatimin e detyrave brenda funksioneve dhe pagave të miratuara. Monitorimi financohet nga programet ekzistuese dhe amendimi nuk kërkon fond shtesë. Koordinimi kryhet nga stafi ekzistues, pa shtesë personeli ose fondi. Për rrjedhojë, kostot e identifikuara nuk përfaqësojnë nevojë për fonde të reja shtesë, por koston e burimeve ekzistuese të angazhuara në zbatimin e kuadrit të propozuar.

Kostot administrative të mundshme për subjektet private nuk janë përfshirë me vlerë monetare, por janë vlerësuar në mënyrë cilësore për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për një përllogaritje të besueshme.

Përllogaritjet janë paraqitur mbi bazën e vlerave totale të kostove për periudhën 10-vjeçare.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Tabelë: Vlera aktuale neto
në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në mijë lekë		Vlera aktuale neto në mijë lekë	
	Kosto		Përfitimi	
Opsioni 0	Nuk është monetizuar		Nuk është monetizuar	Analizë cilësore
Opsioni 1	**21,857**		Nuk është monetizuar	**21,857**
Opsioni 3	Nuk është monetizuar		Nuk është monetizuar	Analizë cilësore

Projekligji nuk krijon kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Zbatimi i tij mbështetet në burimet ekzistuese njerëzore dhe institucionale, ndërsa kostot e parashikuara lidhen vetëm me pagat e punonjësve që do të kryejnë detyrat në kuadër të kompetencave të tyre aktuale. Këto shpenzime janë tashmë të planifikuara në buxhetet e institucioneve përkatëse dhe nuk kërkojnë alokim fondesh shtesë.Për rrjedhojë, projekligji nuk sjell nevoja financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

Përfitimet e projektligjit janë kryesisht mjedisore, institucionale dhe sociale dhe, për shkak të mungesës së një metodologjie të besueshme dhe të dhënave bazë, nuk janë monetizuar në këtë fazë të analizës.